



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 3 regjistër (JR)
Datë 14.01.2020

Nr. 26 i vendimit
Datë 04.08.2021

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Ardian Hajdari	Relator
Ina Rama	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 04.08.2021, në orën 10:00, ditën e mërkurë, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 3/2020, datë 14.01.2020, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Darjel Sina.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 200, datë 16.10.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Besim Hajdarmataj.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 200, datë 16.10.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Besim Hajdarmataj, dhe shkarkimin e tij nga detyra, dëgjoi subjektin e rivlerësimit dhe avokaten e tij Romina Zano, të cilët gjatë dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor kërkuan lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Ardian Hajdari, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Besim Hajdarmataj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.

2. Më parë, në funksion dhe për zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Prokuroria e Përgjithshme, sipas të cilave ka rezultuar:

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- (i) *deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;*
- (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë

¹ Raporti i ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 30.01.2018.

31.10.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit (në vijim “KDZH”) nr. {***}, datë 18.12.2018), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Besim Hajdarmataj.

2.3 Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. {***} prot., datë 03.07.2018, për subjektin e rivlerësimit Besim Hajdarmataj.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e rivlerësimit (të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale) dhe mori vendimin objekt shqyrtimi nr. 200, datë 16.10.2019.

II. Në lidhje me vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 200, datë 16.10.2019, ka disponuar: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Besim Hajdarmataj, me funksion prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda”.
5. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

5.1. Në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë: *Nga hetimi i thellë administrativ për vlerësimin e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit nuk janë konstatuar elemente, të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme dhe, pas verifikimit, rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.*

Në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

5.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës: *Nga hetimi administrativ, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

5.3. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *[...] pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe pas hetimit të pavarur të Komisionit, u vlerësua se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Nuk u provua asnjë indice apo*

element që te cenonte figurën e prokurorit, sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016 [...].

5.4 Komisioni, me vendimin nr. 200, datë 16.10.2019, përfundimisht ka disponuar:

- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj, me funksion prokuror pranë Prokurorisë për Krimet e Rënda, Tiranë.

*- Transferimin e çështjes me nr. {***} akti, të vitit {***}, pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

III. Në lidhje me ankimin dhe shkaqet e ankimit

6. Bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “c” e Aneksit të Kushtetutës, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”), më datë 04.12.2019, ka paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 200, datë 16.10.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Besim Hajdarmataj.

Objekti i këtij rekomandimi lidhet me rezultatet e dala nga hetimi administrativ për (i) kriterin e aftësive profesionale; (ii) kriterin e pasurisë; dhe (iii) vlerësimin në tërësi të çështjes. Si konkluzion, ONM-ja rekomandon që procesi i rivlerësimit për z. Hajdarmataj të rishikohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe, në përfundim, vendimi i Komisionit të ndryshohet.

7. Komisioneri Publik Darjel Sina (në vijim “Komisioneri Publik”) ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 200, datë 16.10.2019, për subjektin e rivlerësimit, duke konsideruar se ndryshe nga sa disponon Komisioni për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.

i. Shkaqe ankimi që lidhen me kriterin e kontrollit të pasurisë

7.1 *Lidhur me gjendjen cash* të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti ka mbajtur gjendje *cash* në banesë përtej limitit 1.500.000 lekë. Komisioneri Publik vlerëson se përfundimi i Komisionit në lidhje me pasurinë likuiditete dhe diferenca negative, në vlerën -980,880 lekë, nuk qëndron sepse nuk bazohet në një vlerësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave të dala gjatë hetimit administrativ.

7.2 *Lidhur me çështjen e banesës në përdorim*, Komisioneri Publik pretendoi se nuk provohet mundësia financiare e vëllait A. H., pasi dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, përveç se nuk është në formën e kërkuar ligjore për vlefshmërinë dhe administrimin e tij, sipas kërkesave të K.Pr.Civile, nuk është i plotë dhe i mjaftueshëm për të konfirmuar mundësinë financiare të vëllait për të përballuar një shpenzim të tillë. Komisioneri Publik vlerëson se detyrimi i subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie nuk është në tejkalim të parashikimeve ligjore, përkundrazi është detyrim kushtetues dhe ligjor në kuadër të procesit të rivlerësimit. Nuk provohet mundësia financiare e vëllait G. H. për të financuar shumën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit pasi vetëm ky shtetas është në marrëdhënie punësimi në këtë familje, pa llogaritur këtu subjektin e rivlerësimit.

7.3 Lidhur me kursimet cash në shumat 6000 euro dhe 4000 paund, Komisioneri Publik pretendoi se në analizë të fakteve dhe provave të administruara, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi mundësinë financiare të vëllait A. H. për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shumat e deklaruara si të dhuruara gjatë viteve 2006-2009, duke konsideruar këtu faktin se vëllai ka kryer një investim në të njëjtat vite për blerjen dhe mobilimin e banesës në shumat 30.000 euro dhe 1.000.000 lekë. Sipas Komisionerit Publik, dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave nuk është në formën e kërkuar nga ligji sipas kërkesave të K.Pr.Civile, si dhe nuk mbulon të gjithë periudhën e analizuar dhe nuk pasqyron në mënyrë të plotë të ardhurat e vëllait me qëllim vlerësimin e tyre sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

7.4 Lidhur me çështje të tjera, si përdorimi i makinës dhe kontaktet, Komisioneri Publik ka parashtruar në ankim se Komisioni ka ardhur në dijeni të kontakteve të subjektit të rivlerësimit me persona me precedentë penalë, si dhe të faktit se ka udhëtuar me ta dhe me makinat e tyre, fakt i cili duhet të shihet në vështrim të vlerësimit tërësor të çështjes. Komisioneri Publik pretendoi se rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar edhe me shtetasit V. K. dhe S. K., të dy të proceduar penalisht. Komisioneri Publik vlerëson se të gjitha rrethanat e mësipërme mbartin në vete dyshimin e arsyeshëm për kontakte të subjektit të rivlerësimit me persona me precedentë penalë, fakt i cili duhet çmuar në vlerësimin tërësor të çështjes, si dhe në kuptim të nenit 4, pika 2 dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

ii. Shkaqe ankimi që lidhen me kontrollin e kriterit të aftësive profesionale

8. **Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit {***},** regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, në të cilën subjekti i rivlerësimit ka pasur rolin e drejtuesit dhe prokurorit që ka hetuar çështjen, Komisioneri Publik pretendoi se qëllimi i subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë hetimi i çështjes në mënyrë shtetërore, për sa kohë janë anashkaluar një sërë veprimesh procedurale të nevojshme hetimore në zbardhjen e çështjes. Komisioneri Publik pretendoi gjithashtu se cilësimi i veprës dhe procedimi penal duhej të regjistrohej për "Kundërshtim të punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik, e kryer në bashkëpunim", parashikuar nga neni 235/2 i Kodit Penal.

8.1 Lidhur me procedimin penal nr. {*} të vitit {***},** të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (subjekti ka qenë në rolin e drejtuesit), të regjistruar mbi bazën e akteve të dërguara për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit posaçërisht për shkak të detyrës funksionale që ushtronte si drejtues i Prokurorisë, kishte të drejtën dhe detyrimin të verifikonte ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, në rastin konkret, mund të udhëzonte me shkrim, kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merrej vendim nga prokurori i çështjes mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji 97/2016").

8.2 Lidhur me procedimin penal nr. {*} të vitit {***},** të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (subjekti ka qenë në rolin e drejtuesit), Komisioneri Publik pretendoi se vendimi për zëvendësimin e prokurorit nga ana e subjektit të rivlerësimit, është pjesërisht i argumentuar dhe nuk gjen mbështetje ligjore, referuar nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale. Nga ana e Prokurorisë, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nuk është kryer asnjë lloj hetimi lidhur me nivelet më të larta të organizatës kriminale, duke përfshirë këtu dhe shtetasin

B. P., në periudhën pas konfiskimit të drogës, për afro dy vite. Ndërkohë gjatë gjithë kësaj periudhe nuk rezultoi e provuar që subjekti të ketë komunikuar me prokurorin e çështjes, të jetë përpjekur të informohet apo të adresojë problematikat.

8.3 Lidhur me procedimin penal nr. {*},** regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ku në përfundim të hetimeve është vendosur dërgimi për kompetencë i procedimit penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, Komisioneri Publik pretendoi se ka pasur mangësi në hetimin e çështjes pasi, për nga sasia e drogës së sekuestruar, personave të përfshirë dhe mangësive të konstatuara, nuk duket bindës ndryshimi i cilësimit të veprave penale nga ana e subjektit të rivlerësimit. Nuk rezultoi që të jenë dokumentuar hetime mbi lëvizjet financiare të të dyshuarve apo të jenë monitoruar telefonatat e tyre, me qëllim identifikimin e personave të tjerë të implikuar apo të konkludohej nëse rasti kishte karakter ndërkombëtar.

8.4 Lidhur me procedimin penal nr. {*}** të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ku kjo e fundit ka shpallur moskompetencën tokësore, duke ia kaluar aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, regjistruar në këtë prokurori si procedimi penal nr. {***} (ku subjekti i rivlerësimit ka qenë drejtues 2013-2015), Komisioneri Publik pretendoi se baza ligjore e referuar nga subjekti i rivlerësimit në arsyetimin e vendimit për transferimin e çështjes, me atë të dispozitivit, është e ndryshme, pasi është disponuar mbi bazën e nenit 76, në vend të nenit 78 të K.Pr.Penale.

8.5 Komisioneri Publik kërkoi që shkaqet e këtij ankimi t'i marrë në shqyrtim Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 200, datë 16.10.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Besim Hajdarmataj.*

9. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kundërankim² ndaj ankimit të Komisionerit Publik lidhur me vendimin e Komisionit nr. 200, datë 16.10.2019, që vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Besim Hajdarmataj. Kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit ndaj shkaqeve të ankimit, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur për kriteret e vlerësimit si më poshtë.

9.1 Në lidhje me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit pretendoi në kundërankim se provat shkresore që ka dorëzuar në mbështetje të shpjegimeve, analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre, në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të kryer nga Komisioni, rezultoi se shkaqet e ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik, në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, janë të pabazuara në ligj, të pabazuara në provat e administruara dhe që nuk referojnë në provat e administruara dhe vlerësuar nga Komisioni, të njëjtat prova mbi të cilat Komisioneri Publik mund dhe duhet të mbështesë ankimin e tij.

9.2 Në lidhje me kontrollin e kriterit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit pretendoi në mënyrë të përmbledhur në kundërankim, se konstatimet e Komisionerit Publik në ankim janë të gabuara, pasi veprimtaria e tij si prokuror i çështjes ose si drejtues prokurorie, në çështjet objekt hetimi administrativ, ka qenë korrekte dhe në përputhje me ligjin. Konstatimet e Komisionerit Publik për vlerësimin si "i papërshtatshëm" nuk bazohen në faktet që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ dhe parashikimet e ligjit lidhur me vlerësimin e këtij kriteri, në kuptim të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 44, pika "c" e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 78 të ligjit nr.

² I protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 10.01.2020.

96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji nr. 96/2016").

9.3 Në përfundim, subjekti i rivlerësimit nëpërmjet kundërankimit, kërkoi:

- *Mospranimin e ankimit të Komisionerit publik pasi shkaqet e ankimit janë të pabazuara në ligj dhe në provat e administruara në kuadër të procesit të rivlerësimit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 200, datë 16.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

i. Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm i Apelit (në vijim "Kolegji") ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimitimi i ankuesit

11. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

12. Në përputhje me nenin 65³, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 200, datë 16.10.2019, për subjektin e rivlerësimit Besim Hajdarmataj, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.

³ *Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".*

B. Mbi aspektet procedurale lidhur me provat dhe kërkesat e Komisionerit Publik dhe atyre të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor, Kolegji konstaton si më poshtë.

13. Në seancën gjyqësore publike të datës 21.06.2021, Komisioneri Publik, në parashtrimet e depozituara në Kolegji, pasi u shpreh se u qëndron shkaqeve të ankimit, mbështetur në parashikimet e nenit F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit.
14. Subjekti i rivlerësimit, me parashtrimet e tij të depozituara në Kolegji në seancën e datës 21.06.2021, kërkoi riçeljen e hetimit gjyqësor sipas nenit 51, paragrafi 1, germa “c” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe marrjen në shqyrtim në seancë gjyqësore të provave të depozituara prej tij, të cilat u pranuan nga Kolegji në këtë seancë gjyqësore dhe renditen si më poshtë.
 1. Shkresë nr. {***} prot., datë 30.04.2014, e Prokurorisë së Përgjithshme, bashkëngjitur urdhri i regjistrimit të procedimit penal, si dhe urdhri i regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale.
 2. Shkresë e sekretarit të përgjithshëm pranë Kuvendit me nr. {***}, datë 01.06.2021, bashkëngjitur aktet ligjore dhe relacionet përkatëse.
 3. Deklaratë nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 21.12.2018, e deklaruesit B. M..
 4. Vërtetim dhe verifikim dokumentacioni me nr. {***} rep., datë 19.06.2021, i hartuar nga noteri për dokumentin e dërguar me postë elektronike nga shtetasi S. H..
 5. Ftesë e Federatës Panshqiptare “Vatra”, datë 31.10.2013, drejtuar subjektit të rivlerësimit.
 6. Vërtetim dhe verifikim dokumentacioni me nr. {***} rep., datë 19.06.2021, i hartuar nga noteri për dokumentin e dërguar me postë elektronike nga shtetasi A. H. te posta elektronike e subjektit të rivlerësimit.
15. Në funksion të seancës gjyqësore të datës 21.06.2021, subjekti i rivlerësimit dërgoi paraprakisht disa prova, të cilat u protokolluan në Kolegji me nr. {***}, datë 15.06.2021, për të cilat subjekti i rivlerësimit kërkoi të shqyrtohen në seancë gjyqësore publike, pasi lidhen me shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik dhe që i shërbejnë zhvillimit të një procesi të drejtë gjyqësor. Këto prova të tjera renditen si më poshtë.
 1. Deklaratë noteriale e A. H., hartuar përpara noterit në Londër, më 21 korrik 2020.
 2. Gjendje bankare e A. H. në datën 21.12.2009, e lëshuar nga banka *Barclays* në Mbretërinë e Bashkuar (dokumentacion i përkthyer në shqip, noterizuar dhe i pajisur me vulë apostile).
 3. Vërtetim, datë 11.12.2007, lëshuar nga Tesco Personal Finance, drejtuar A. H..
 4. Konfirmim, datë 06.11.2018, i lëshuar nga kompania AKS, drejtuar A. H..
 5. Konfirmim elektronik, datë 01.07.2020, nga zyra e Taksave dhe Doganave për të ardhurat dhe kontributet e A. H. për periudhën 2006-2016.
 6. Kopje e pasaportës së A. H..
 7. Deklaratë personale e punëdhënësit të z. A. H., hartuar përpara avokatit A.-U. K. më datë 26.05.2021 (dokumentacion i përkthyer në shqip, noterizuar dhe i pajisur me vulë apostile).
 8. Deklarim noterial i punëdhënësit të z. A. H., hartuar para noterit në Londër, më datë 20.11.2020 (dokumentacion i përkthyer në shqip, noterizuar dhe i pajisur me vulë apostile).

9. Vërtetim nga Zyra e Gjendjes Civile, Bajram Curri, Tropojë, me nr. {***} prot., datë 20.05.2021.
10. Vërtetim nga Zyra e Gjendjes Civile Tropojë, me të njëjtin nr. prot., të njëjtën datë 20.5.2021.
11. Vërtetim page e G. H., lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, datë 30.04.2021.
12. Vërtetim, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Tropojë, me nr. {***} prot., i datës 08.06.2021.
13. Vërtetim, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Tropojë, me nr. {***} prot., datë 26.05.2021.
14. Kërkesë e z. Besim Hajdarmataj drejtuar Prokurorisë pranë Gjatës së Shkallës Parë, Kurbin, si dhe shkresë e Prokurorisë pranë Gjatës së Shkallës së Parë Kurbin, nr. {***} prot., datë 17.05.2021.
15. Kërkesë e z. Besim Hajdarmataj drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe shkresë e Prokurorisë në përgjigje që dërgon dokumentacionin nr. {***} prot., datë 21.05.2021.
16. Vlerësim pune nga Prokurori i Përgjithshëm për z. Besim Hajdarmataj, për vitet 2014-2016.
17. Shkresa e Prokurorisë së Përgjithshme me nr. {***} prot., datë 23.01.2020, bashkëlidhur vendimi nr. {***}, datë 22.10.2020, i Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.
16. Në datën 30.06.2021, subjekti i rivlerësimit paraqiti në Kolegj provat për të cilat i kishte lënë detyrë Kolegji në seancën e datës 21.06.2021, që të paraqiten në formën e kërkuar nga ligji. Këto prova u protokolluan në Kolegj me nr. {***}, datë 30.06.2021, dhe citohen si në vijim.
1. Deklaratë personale e A. H., e hartuar përpara avokatit A.-U. K., më datë 23.06.2021 (deklarata e përkthyer në shqip, noterizuar dhe e pajisur me vulë apostile).
 2. Dokument elektronik, datë 10.06.2021, nga zyra e Taksave dhe Doganave për periudhën e punësimit të z. A. H..
 3. Dokument elektronik, datë 10.06.2021, nga zyra e Taksave dhe Doganave për të ardhurat dhe taksat për periudhën 2009-2010 të z. A. H..
 4. Dokument elektronik, datë 10.06.2021, nga zyra e Taksave dhe Doganave për të ardhurat dhe taksat për periudhën 2010-2011 të z. A. H..
 5. Dokument elektronik, datë 11.06.2021, nga zyra e Taksave dhe Doganave për të ardhurat dhe taksat të z. A. H..
- Dokumentacioni nga pika 2 - 5 është i përkthyer në shqip dhe i noterizuar.
17. Kolegji çeli hetimin gjyqësor për të mundësuar hetimin e fakteve të pretenduara në ankim dhe kundërankim, duke i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të mbrohet dhe të japë shpjegimet e tij në lidhje me to. Për pasojë, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në seancë publike në Kolegj, të listuara më sipër, për sa ato lidheshin me shkaqet e ankimit dhe nevojën e subjektit të rivlerësimit për t'i prapësuar ato, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Kolegji vendosi të lejojë marrjen dhe nënshkrimin e tyre debatit gjyqësor e më pas i vlerësoi ato në raport me vendimin objekt shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik. Pasi u vlerësuan edhe provat e reja

të sjella nga subjekti i rivlerësimit në formën e kërkuar nga ligji, të cilat iu nënshtruan debatit gjyqësor, Kolegji arriti në konkluzionet e mëposhtme.

C. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik dhe kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit në kundërankim

i. Shkaqe ankimi dhe kundërankimi që lidhen me kontrollin e kriterit të pasurisë

18. Lidhur me gjendjen cash, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti e ka mbajtur në banesë përtej limitit 1.500.000 lekë. Komisioneri Publik vlerëson se përfundimi i Komisionit në lidhje me pasurinë likuiditete dhe diferenca negative në vlerën -980,880 lekë, nuk qëndron sepse nuk bazohet në një vlerësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave të dala gjatë hetimit administrativ. Komisioneri Publik, në kuadër të vlerësimit të elementeve përbërëse të analizës financiare të Komisionit, pretendoi se nuk duhet të ishin marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat nga përfitimi financiar i shërbimit të transportit dhe shpenzimet e jetesës. Sipas Komisionerit Publik, në analizën financiare të periudhës 2003-2016, subjekti i rivlerësimit rezulton me diferencë negative në vlerën -1,145,121 lekë. Komisioneri Publik konsideron se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruara në deklaratat periodike, si dhe nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pasaktësisë dhe pamjaftueshmërisë së deklaramit të pasurisë, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

18.1 Subjekti i rivlerësimit në kundërankim, lidhur me këtë shkak ankimi, ka pretenduar se argumenti i Komisionerit Publik se nuk duhet të vlerësohen shpenzimet e jetesës sipas kërkesës së subjektit të rivlerësimit, bazuar në Institutin e Statistikave për minimum jetik, nuk gjen mbështetje. Sipas subjektit, shpenzimet familjare janë deklaruar në shumën 25.000 - 30.000 lekë në muaj, pasi kursimet e tij në *cash* administroheshin nga nëna e tij, e cila menaxhonte edhe shpenzimet familjare. Në këtë mënyrë, paratë e kursyera prej saj janë deklaruar si shtesa në kursimet *cash*, në fund të çdo viti, duke deklaruar gjendjen reale të kursimeve që ishin akumuluar. Sipas subjektit të rivlerësimit, të ardhurat nga përfitimi financiar i shërbimit të transportit nuk janë shpenzuar tërësisht prej tij dhe përbëjnë të ardhura me burim të ligjshëm, ndaj nuk ka asnjë shkak ligjor që të përjashtohen nga analiza financiare. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se nga qëndrimet e mbajtura nga Komisioni dhe Kolegji me subjektet e tjera të rivlerësimit, nuk mund të kryhet një vlerësim i ndryshëm për përlllogaritjen e shpenzimeve për jetesë, duke krijuar rritje artificiale të shpenzimeve jetike me qëllim nxjerrjen patjetër të një balance negative.

18.2 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Komisioni vlerëson se shpjegimet dhe provat e paraqitura në lidhje me të ardhurat e tepruara nga shpenzimet për transportin, faktet bindëse për shkak se nuk ka disponuar automjet në pronësi, si dhe ka shpjeguar ndarjen e shpenzimeve të transportit me koleget e tij dhe për pasojë, trupi gjyqësor ka krijuar bindjen se subjekti i rivlerësimit provoi mundësinë për të pasur këto likuiditete, pasi një pjesë e këtyre të ardhurave kanë arritur të*

kursehen nga subjekti, duke arritur në konkluzionin se trajtimi i bonusit të transportit duhet të llogaritet pjesërisht si e ardhur e subjektit për këto vite, si dhe për faktin se natyra e analizës financiare është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson, krahasuar me aspektet konkrete të jetës reale. Trupi gjykues, në përfundim të analizës financiare të kryer për periudhën 2003 – 2006, pas analizës dhe arsytimit të mësipërm, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme financiare për të krijuar depozitat e deklaruara, kursimet cash dhe për të mbuluar shpenzimet.

18.3 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* ka deklaruar, ndër të tjera, gjendje *cash* 500.000 lekë, me burim krijimi kursimet e realizuara nga data 01.01.2016 deri më datë 31.12.2016. Si dhe gjendje *cash*, në monedhë të huaj, në vlerën 6000 euro dhe 4000 paund, me burim krijimi dhurata të marra nga vëllai me banim në Mbretërinë e Bashkuar, të dërguara në vitet 2007, 2008 dhe 2009. Komisioni kreu analizën financiare për të vërtetuar saktësinë e burimeve financiare të deklaruara, kursimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit deri në vitin 2016, si dhe mundësitë për të kursyer bazuar te të ardhurat e deklaruara dhe të dokumentuara, shpenzimet dhe likuiditetet gjatë kësaj periudhe. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare, Komisionit i rezultoi se llogaria e subjektit është kredituar me një pagesë mujore si përfitim financiar i shërbimit të transportit, për shkak të funksionit të drejtuesit, të cilat rezultojnë në vlerat si vijojnë: për vitin 2010, në shumën 420.000 lekë; për vitin 2011, në shumën 385.000 lekë; për vitin 2012, në shumën 420.000 lekë; për vitin 2013, në shumën 350.000 lekë, të ardhurat në total nga përfitimi financiar i shërbimit të transportit në shumën 1.575.000 lekë. Komisioni nuk i ka përfshirë këto të ardhura në analizën financiare, me arsytimin se janë përdorur për transport nga subjekti i rivlerësimit. Analiza e kryer nga Komisioni për periudhën 2003 – 2016 ka rezultuar në katër vite radhazi (2010-2013) me një balancë negative, në shumën 980.000 lekë. Për këtë arsye, Komisioni i kaloi barrën e provës dhe i kërkoi subjektit të rivlerësimit për të dhënë shpjegime apo prova, për të provuar të kundërtën lidhur me balancën negative për vitet 2010 – 2013.

18.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të Komisionit, pas kalimit të barrës së provës, në prapësimet e datës 01.04.2019, ka sqaruar se: *Në lidhje me shpenzimin e këtij përfitimi financiar, mund të shpjegoj dhe provoj se ndërkohë që nuk kisha në pronësi posedim ose përdorim ndonjë autoveturë apo mjet transporti, përgjatë kësaj periudhe u jam bashkuar në udhëtim kolegëve prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore, të cilët udhëtonin nga Tirana për në Kurbin dhe anasjelltas për periudhën janar 2010 deri në fund të muajit dhjetor 2013. [...] kur udhëtonim me mjetet e kolegëve, kemi paguar secili sipas periudhave të udhëtimit nga 7000 deri në 10.000 lekë në muaj, duke përjashtuar muajin gusht të lejeve vjetore dhe, nga përlllogaritjet, unë kam shpenzuar për vitin 2010 shumën 92500 lekë, për vitin 2011 shumën 82500 lekë, në vitin 2012 shumën 102500 lekë, ndërsa shuma e mbetur nga bonusi është përlllogaritur si shpenzimjetese dhe kursimi.*

18.5 Siç vërehet nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, duheshin marrë në konsideratë të ardhurat nga përfitimi financiar i shërbimit të transportit, sepse subjekti ka mundur të kursejë këtë

vlerë duke qenë se ka udhëtuar me kolegë të tjerë. Për këtë rast, subjekti i rivlerësimit, bashkëngjitur prapësimeve, ka paraqitur në Komision dy deklarata noteriale me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 04.04.2019 dhe deklarata noteriale me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 04.04.2019. Në këto deklarata, deklarues janë subjekte rivlerësimi, z. G. V., z. K. B., z. B. M., z. E. K. dhe z. Sh P., të cilët deklarojnë se kanë udhëtuar së bashku për t'u paraqitur në punë dhe kanë ndarë shpenzimet e transportit me njëri- tjetrin, ku jepen edhe detaje të hollësishme lidhur me shpenzimet dhe kontributin e secilit sa u takon shumave të shpenzuara në periudhën 2010-2013. Duke iu referuar praktikës së konsoliduar të Kolegjit, sjellim në vëmendje jurisprudencën⁴ që ka mbajtur në çështje të ngjashme, sipas të cilave deklarata noteriale, megjithëse nuk është e pavlefshme, në kuptim të legjislacionit për noterinë, ajo merret me rezervë në këtë proces, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështetet nga provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.

18.6 Kolegji vëren se, pas prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka ndryshuar përlllogaritjet e shpenzimeve të jetesës duke vendosur shpenzimet e përlllogaritura nga ILDKPKI-ja, të bazuara në anketat e matjes së nivelit të jetesës nga INSTAT-i. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, u vlerësuan të gjitha metodat e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës, analizë e cila rezultoi negative me të gjitha këto metoda. Kolegji arriti në përfundimin se shpenzimet e jetesës për subjektin e rivlerësimit, do të konsiderohen sipas shpjegimeve të tij të dhëna në pyetësin e datës 20.11.2018. Për periudhën 2010-2013, diferenca mes të ardhurave të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe shpenzimeve të kryera prej tij rezulton një diferencë negative në vlerën 1.046.550 lekë. Në lidhje me përlllogaritjen e të ardhurave nga përfitimi financiar i shërbimit të transportit, bazuar edhe në jurisprudencën⁵ e Kolegjit për to, në analizën financiare të kryer në Kolegj, këto vlera nuk janë përfshirë në zërin “të ardhura”, duke qenë se kanë pasur një destinacion të caktuar për të mbuluar një shpenzim të lidhur me udhëtimet për arsye pune, në një qytet tjetër larg vendbanimit dhe subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte se kishte kursyer një pjesë të tyre.

18.7 Në vitin 2013, subjekti i rivlerësimit ka kryer një udhëtim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, saktësisht në datat 26.11.2013 - 10.12.2013. Gjatë pyetësorëve në Komision dhe gjithashtu gjatë seancave gjyqësore në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se gjatë këtij udhëtimi ka kryer shpenzime qëndrimi më të ulëta se ato të llogaritura. Në pyetësin e dërguar në Komision, subjekti ka paraqitur biletën e udhëtimit e cila ka kushtuar 600,35 euro dhe ka deklaruar se ka qëndruar 6 net në hotel i cili, sipas subjektit, ka kushtuar 400 USD, në total, sipas subjektit, ky udhëtim ka kushtuar rreth 126.484 lekë (e konvertuar sipas kursit të publikuar nga Banka e Shqipërisë).

⁴ Vendimi nr. 6/2018(JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36.

Vendimi nr. 11/2019(JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1.

Vendimi nr. 34/2019(JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 02.12.2019, paragrafi 85.2.

Vendimi nr. 36/2020(JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 16.12.2020, paragrafi 16.6.

⁵ Vendimi nr. 7/2019(JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 05.04.2019, paragrafi 36.

Në përlogaritjen në Kolegj, është konsideruar vlera e biletës e cila është e dokumentuar nga subjekti i rivlerësimit dhe pjesa e ditëve të qëndrimit është përlogaritur sipas metodologjisë së konsoliduar në Kolegj dhe ky udhëtim, sipas kësaj përlogaritjeje, ka qenë në vlerën 182.395 lekë. Pra, diferenca mes përlogaritjes në Kolegj dhe asaj të subjektit të rivlerësimit është në vlerën 55.911 lekë, e cila edhe sikur të reduktohej nga diferenca negative e këtij viti, ajo do të mbetej përsëri negative.

18.8 Kolegji vëren se lidhur me mbajtjen e gjendjes *cash* në banesë nga subjekti i rivlerësimit, për të cilën Komisioneri Publik pretendoi se e ka mbajtur përtej limitit ligjor të përcaktuar nga shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* ka deklaruar: “[...] (iii) gjendje *cash* në shumën 500.000 lekë, me burim të ardhurat nga paga për periudhën 01.01.2016 - 31.12.2016; dhe (iv) gjendje *cash* në shumat 6.000 euro dhe 4.000 paund, me burim të deklaruar dhurata nga vëllai me banim në Mbretërinë e Bashkuar, të dërguara në vitet 2007, 2008 dhe 2009. Totali i këtyre gjendjeve *cash* të deklaruara në deklaratën *vetting* tejkalon vlerën 1,5 milionë lekë. Në udhëzimin nr. 4095, datë 10.10.2016, *Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e Shqipërisë”, në nenin 17 të tij parashikohet: Deklarimi i gjendjes “cash” do të njihet si i tillë në konceptin e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, deri në kufirin e shumës 1,5 milionë lekë. Shumat më të mëdha duhet të formalizohen në sistemin bankar, përpara dorëzimit të deklaratës në ILDKPKI, duke bashkëlidhur në çdo rast vërtetimin bankar për këtë veprim. Si rrjedhojë e këtij parashikimi të cituar edhe në shtojcën 2 të ligjit 84/2016, subjekti i rivlerësimit jo vetëm nuk duhej të mbante gjendje *cash* jashtë sistemit bankar në shumën mbi 1,5 milionë lekë, por duhej t’i formalizonte në sistemin bankar, si dhe të provonte me dokumentacion të bashkëlidhur veprimin bankar të këtij depozitimi. Sa më sipër, shkak i ankimit i ngritur nga Komisioneri Publik, gjendet i bazuar.*

18.9 Kolegjit i rezultoi nga analiza e këtij shkak ankimi, se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën *vetting*, afektuar kjo nga diferenca negative e periudhës 2010-2013 në vlerën 1.046.550 lekë, për të cilat subjekti pretendoi se ka kursyer nga përfitimi financiar i shërbimit të transportit. Si rrjedhojë, bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, kursimet dhe shpenzimet e krijuara në këto vite.

19. *Lidhur me çështjen e banesës/apartamentit në përdorim*, Komisioneri Publik pretendoi se nuk provohet mundësia financiare e vëllait A. H. për të financuar blerjen e apartamentit, pasi dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, përveç se nuk është në formën e kërkuar ligjore për vlefshmërinë dhe administrimin e tij, sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Civile, nuk është i plotë dhe i mjaftueshëm për të konfirmuar mundësinë financiare të vëllait për të përballuar një shpenzim të tillë. Komisioneri Publik vlerëson se detyrimi i subjektit të rivlerësimit, për të provuar

ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie nuk është në tejkalim të parashikimeve ligjore, përkundrazi është detyrim kushtetues dhe ligjor në kuadër të procesit të rivlerësimit. Nuk provohet mundësia financiare e vëllait G. H. për të financuar shumën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

19.1 *Subjekti i rivlerësimit në kundërrankimin e paraqitur prej tij, pretendoi se zgjedhja për të jetuar me familjarët dhe për të qenë pranë tyre nuk passjell asnjë të drejtë ligjore pronësie/bashkëpronësie/posedimi mbi këtë pasuri në kuptim të nenit 149 dhe 304 të Kodit Civil. Lidhur me mënyrën e krijimit të kësaj pasurie, siç ka rezultuar nga tërësia e dokumentacionit të administruar nga Komisioni dhe hetimi i zhvilluar, kjo banesë është blerë me kontributin e dy vëllezërve të tij. Ky është fakti i vetëm për të cilin subjekti pretendon se është pyetur gjatë hetimit administrativ dhe është përgjigjur lidhur me kontributin e dhënë prej tyre për blerjen e banesës. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vëllezërit e tij nuk janë "persona të tjerë të lidhur", për të cilët duhet të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie të blerë prej tyre, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që nuk rezulton që në momentin e krijimit të kësaj pasurie apo në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, ata të kenë qenë në të njëjtën përbërje familjare me subjektin, sikurse pretendoi Komisioneri Publik në ankim.*

19.2 *Arsyetime i Komisionit për këtë pasuri: Nga hetimi i kryer, nuk rezultoi asnjë situatë e dyshuar e rrethana objektive se personat e tjerë të lidhur mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, pra, trupi gjykues vlerëson se subjekti provoi ligjshmërinë e burimit të krijimit për personin tjetër të lidhur, për shumat e dhuruara në vlera monetare dhe se pasuria e personave të tjerë të lidhur nuk ishte objekt verifikimi i këtij trupi gjykues, në përputhje me sa parashikon neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.*

19.3 *Kolegji vëren se në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme në posedim apo përdorim. Subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij (6 anëtarë) jetojnë në të njëjtën banesë, në të cilën subjekti deklaroi se përdor një dhomë, të mobiluar me shpenzimet e tij. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar disa herë adresën e banimit/qëndrimit. Komisioni ka hetuar lidhur me këtë fakt dhe nga hetimi dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, ka rezultuar se subjekti nga maji i vitit 2009 e në vijim, banon në adresën: Njësia Administrative nr. {***}, rr. "{***}", pallati nr. {***}, shk. {***}, ap. {***}, Tiranë. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo adresë i përket shtëpisë së vëllezërve të tij, G. dhe A. H.. Komisioni ka konstatuar se pasuria "apartament" është blerë e likuiduar në vitin 2007, ku subjekti nuk ishte as kontribuues e as përdorues i kësaj pasurie, pasi dhe sipas deklaramit periodik vjetor, deri në vitin 2009 ka banuar në një banesë tjetër me qira, për faktin se apartamenti është deklaruar si pasuri e blerë nga vëllezërit, se personat e tjerë të lidhur nuk disponojnë banesë tjetër në pronësi. Subjekti i rivlerësimit, sipas certifikatës familjare të administruar, paraqitet i vetëm, si dhe për faktin që deklarimet e tij përputhen me deklaratën e pasurisë së vëllait si subjekt deklarues, Komisioni nuk ka konstatuar ndonjë rrethanë dyshuese për këtë pasuri.*

19.4 Komisioni, duke marrë indicie nga denoncimet anonime nr. {***} prot., datë 05.04.2019; nr. {***} prot., datë 08.04.2019, si dhe nga një denoncim anonim në adresë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, i cili u përcoll në Komision në datën 09.04.2019, ka kryer hetim shtesë për kriterin e pasurisë, duke kërkuar informacion nga institucionet publike dhe private. Në këto denoncime ngriheshin pretendime për pasuri të paluajtshme të subjektit, të regjistruar në emër të personave të tjerë, por këto pretendime nuk ishin të mbështetura në ndonjë provë konkrete. Referuar këtyre denoncimeve, Komisioni kreu një hetim të thellë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e përmendur në këto denoncime, duke i kërkuar informacion ILDKPKI-së, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, për të verifikuar pasuri të regjistruara në emër të këtyre personave. Nga informacioni dhe dokumentacioni i ardhur nga këto institucione publike, u konfirmuan të njëjtat pasuri që Komisionit i kanë rezultuar nga hetimi administrativ, duke mos u provuar informacionet për pasuri të fshehura, sipas denoncimeve anonime.

19.5 Siç është shpjeguar më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar asnjë pasuri në posedim apo përdorim nga ana e tij në deklaratën *vetting* apo në deklaratat periodike të pasurisë. Në pyetësorët e drejtuar subjektit nga Komisioni, rezultoi se ai ka deklaruar se banon në apartamentin në pronësi të vëllezërve të tij. Nga aktet e administruara në dosje, apartamenti me sip. 112 m² rezultoi se është porositur me kontratën nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 12.09.2007, nga G. H. (apartament i paregjistruar⁶ në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, për shkak të aplikimit pranë Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale (në vijim “ALUIZNI”), në shoqërinë “{***}” ShPK) në vlerën 52.580 euro. Vlera sipas kontratës është shlyer plotësisht, jashtë zyrës noteriale, në momentin e hartimit të kontratës. Gjatë hetimit në Komision, subjekti është pyetur për burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të *e-mail*-it të datës 20.11.2018, është përgjigjur se pagesa për blerjen e apartamentit është kryer nga vëllezërit e tij në vlerat e mëposhtme.

- 30.000 euro, kontribut i vëllait A. H., me burim nga punësimi i tij në Angli.
- 22.580 euro, vëllai G. H., nga kursimet personale dhe 10.000 euro vëllai i subjektit i ka marrë hua nga një shtetas tjetër.
- Për mobilimin e këtij apartamenti ka kontribuar vëllai i subjektit të rivlerësimit A., në shumën 1.000.000 lekë, me burim nga emigracioni.
- Subjekti i rivlerësimit në këtë banesë ka kontribuar vetëm shumën 100.000 lekë për mobilimin e dhomës së tij të gjumit.

19.6 Në analizë të kësaj situatë faktike dhe ligjore, Kolegji sjell në vëmendje jurisprudencën⁷ e tij ku arsyetohet se parashikimet e nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 shërbejnë për të përcaktuar rrethin e personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit në kontekst më të gjerë, si në

⁶ Sipas kthimit përgjigjes së shoqërisë “{***}”, me nr. {***} prot., datë 23.01.2019.

⁷ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019, paragrafët 107, 108, 109; vendimi nr. 20/2019 (JR), datë 08.09.2020, paragrafi 21.3; vendimi nr. 36/2020, datë 16.12.2020, paragrafi 21.8.

funksion të deklarimit e verifikimit të çdo situatë të mundshme të konfliktit të interesit, pjesë gjithashtu e detyrueshme për kontroll si nga ILDKPKI-ja (shih nenin 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016), ashtu edhe nga vetë organet e rivlerësimit, edhe në funksion të përcaktimit të detyrimit të subjekteve të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Ky detyrim i subjektit të rivlerësimit rezulton i qartë, përcaktuar në rrethana të veçanta, kur këta persona të tjerë të lidhur të kenë si elemente të detyrueshme në marrëdhënien me subjektin e rivlerësimit, një marrëdhënie huaje apo dhurimi, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Pra, në këndvështrim të Kolegjit, një subjekt rivlerësimi do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi, në raste të tjera, pasuria e personave të tjerë të lidhur duhet të jetë objekt verifikimi, legjitimuar nga ekzistenca e dyshimeve për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo ekzistencës së një konflikti të mundshëm interesi.

19.7 Në këto kushte, pavarësisht disa rrethanave të konstatuara në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament banimi në pronësi të vëllezërve të subjektit të rivlerësimit, Kolegji arsyeton se nuk mund të merren në analizë të ardhurat e vëllait të subjektit të rivlerësimit në rastin konkret, pasi nuk është në rrethin e personave të tjerë të lidhur, siç u sqarua më lart, si dhe të gjendur në kushtet e mungesës së dyshimeve për konflikt të mundshëm interesi apo pasuri të fshehura pas hetimit të thelluar të kryer nga Komisioni, vlerësohet se verifikimi i mëtejshëm i tyre do të kapërcente kufijtë e objektit të procesit të rivlerësimit. Nga ana tjetër, rrethanat faktike të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me kontributin financiar të vëllait të tij A. H., në drejtim të financimit të blerjes së pasurisë që shërben si banesë e subjektit të rivlerësimit, mbeten jobindëse se kanë ndodhur, pas një analize logjike e të arsyeshme të rastit konkret, dhe u konsideruan me këtë status prej Kolegjit në vlerësimin tërësor të çështjes.

20. *Lidhur me kursimet cash në shumat 6000 euro dhe 4000 paund*, Komisioneri Publik pretendoi se në analizë të fakteve dhe provave të administruara, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi mundësinë financiare të vëllait A. H. për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shumat e deklaruara si të dhuruara gjatë viteve 2006-2009, duke konsideruar këtu faktin se vëllai ka kryer një investim në të njëjtat vite për blerjen dhe mobilimin e banesës/apartamentit, në shumat 30.000 euro dhe 1.000.000 lekë (cituar në paragrafin 19.5 më sipër). Sipas Komisionerit Publik, dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave, nuk është në formën e kërkuar nga ligji, sipas kërkesave të K.Pr.Civile, si dhe nuk mbulon të gjithë periudhën e analizuar dhe nuk pasqyron në mënyrë të plotë të ardhurat e vëllait me qëllim vlerësimin e tyre sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Si rrjedhojë, nuk u provua aftësia e personit tjetër të lidhur që me të ardhura nga burime të ligjshme t’i dhuronte subjektit të rivlerësimit shumat 6.000 euro dhe 4.000 paund, të deklaruara nga subjekti si kursime *cash* në deklaratën *vetting*.

20.1 Subjekti i rivlerësimit në kundërankim kundërshtoi se gjatë hetimit administrativ, ka përmbushur detyrimin për të sjellë prova të mjaftueshme për të provuar mundësinë e dhurimit të shumave përkatëse dhe burimin e ligjshëm të krijimit të tyre. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se

nuk i është kërkuar asnjëherë të provojë të ardhurat e plota të vëllait të tij, të cilat kanë shërbyer për blerjen e banesës, për të vetmin shkak se ai nuk është konsideruar person tjetër i lidhur në kuptim të ligjit me subjektin e rivlerësimit, në raport me këtë pasuri. Vëllai është konsideruar i tillë, pretendoi subjekti, vetëm në marrëdhënien e dhurimit që i ka lidhur bashkë. Nëse do të konsiderohej i tillë dhe do t'i ishin kërkuar shpjegime dhe prova për këtë fakt, sikurse ka vepruar gjatë gjithë hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, do të kishte sjellë prova në lidhje me të ardhurat e plota të tij, gjatë viteve të punësimit në Angli. Fakti që vëllai në kuptim të ligjit dhe praktikës gjyqësore të organeve të rivlerësimit, nuk është person i lidhur dhe nuk mund të konsiderohet i tillë në raport me pasuritë e tjera të blera prej tij, nuk mund të çojë në konkluzionin e pavërtetë të parashtruar nga Komisioneri Publik, se nuk ka arritur të provojë mundësinë e dhurimit të shumave përkatëse dhe ligjshmërinë e krijimit të tyre, pasi nga provat që janë administruar dhe vendimi i Komisionit, ky fakt rezulton tërësisht i qartë dhe i provuar.

20.2 Arsyetimi i Komisionit për këtë çështje: *Pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit lidhur me vërtetësinë e deklaramëve, ka rezultuar se subjekti ka deklaruar në deklaratimet periodike të viteve 2007, 2008, 2009 se këto dhurata janë dhënë nga vëllai i tij. Nga hetimi i kryer, u konstatua se nga verifikimi në sistemin TIMS, rezultoi se vëllai i subjektit ka hyrjedalje që prej vitit 2006 e në vijim, referuar dhe fotokopjes së pasaportës të vënë në dispozicion nga subjekti për periudhën 2006 – 2009. Trupi gjykues arrin në përfundimin se dokumentacioni ligjor i paraqitur nga subjekti është i plotë dhe në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe në bazë të këtij dokumentacioni, të ardhurat e ligjshme të vëllait për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Lidhur me ligjshmërinë e tyre, trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të depozituar sa më sipër, vlerëson dhe provon se të ardhurat për periudhën 2006 – 2009 janë në vlerën 26.106 paund, duke përmblusur në këtë mënyrë detyrimin ligjor të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, për justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të masës së të ardhurave të dhuruara nga vëllai i tij, në raport edhe me shpenzimet jetike.*

20.3 Kolegji vëren se në dokumentacionin e administruar në dosje, rezulton se në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Gjendje cash në monedhë të huaj, në vlerën prej 6000 euro dhe 4000 paund. Burimi i krijimit: dhuratë nga vëllai.*

Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Janë shtuar të ardhura nga vëllai A. nga Anglia, të pashoqëruara me dokument, ardhur në rrugë private 3000 euro.*

Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Janë shtuar të ardhura nga vëllai A., i cili ndodhet me dokumente në Mbretërinë e Bashkuar, shtuar 4000 paund.*

Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *1. Në fillim të vitit 2009, kemi pasur cash në shtëpi vlera monetare në shumën prej 1.000.000 (një milion) lekë, 4000 (katër mijë) paund dhe 3000 (tre mijë) euro. Kjo pasuri është e përbashkët dhe burimi është nga paga ime dhe vëllait G.it dhe vlera monetare të sjella nga vëllai A., i cili është në qëndrim me dokumente në Mbretërinë e Bashkuar. 2. Janë shtuar, nga paga ime, paga e vëllait G. dhe nga paga e vëllait A.t për periudhën nga deklarimi i mëparshëm 500.000 lekë dhe 3000 euro [...].*

3. Vlerat monetare të deklaruara nga ana ime, ndodhen në cash në shtëpi.

20.4 Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, me provat që ka dorëzuar dhe janë administruar në Komision, nuk provon mundësinë financiare të vëllait të tij për dhurimin e shumave 6000 euro dhe 4000 paund, u krye analiza financiare e subjektit të rivlerësimit për vitet 2007, 2008 dhe 2009. Duke mos i konsideruar si të ligjshme dhurimet e *cash*-it të vëllait nga Anglia, për shkak të pamundësisë së tij financiare për t'i krijuar, u llogaritën shpenzime jetese vetëm për subjektin e rivlerësimit sipas deklaramit të tij për kontribut në familje. Subjekti nuk kishte mundësi të përballonte jetesën dhe gjithashtu të krijonte kursime për vitet 2007, 2008, 2009 në vlerën negative prej 188.550 lekësh.

20.5 Subjekti i rivlerësimit, gjatë seancave gjyqësore në Kolegj, solli prova të reja për të provuar të kundërtën e shkaqeve të ngritura në ankim nga Komisioneri Publik. Për të provuar të ardhurat e vëllait në Mbretërinë e Bashkuar, subjekti solli dokumentacionin e mëposhtëm, i cili është cituar në paragrafin nr. 16 më sipër.

1. Dokumentacion bankar nga banka "Barclays" në Mbretërinë e Bashkuar, për vërtetimin e marrjes së një kredie bankare në vlerën 15.000£.
2. Dokumentacion bankar nga "Tesco Personal Finance", për kredinë e marrë nga vëllai i subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortja e tij, në shumën 18.026 paund, më datë 11.12.2007.
3. Dokumentacion i lëshuar nga kompania "AKS", për periudhën e punësimit të vëllait të subjektit të rivlerësimit për periudhën maj 2005 - janar 2007.
4. Dokumentacion i lëshuar nga zyra e Taksave dhe Tatimeve (HM Revenue and Customs), për vërtetimin e kontributeve dhe taksave të derdhura nga vëllai i subjektit të rivlerësimit për periudhën 2006-2016.
5. Deklaratë e lëshuar më datë 20.11.2020, nga punëdhënësi të A. Hajdarmataj.

20.6 Pas administrimit të provave të mësipërme në Kolegj, u krye sërish analiza e të ardhurave të vëllait të subjektit të rivlerësimit, nga e cila rezultoi:

Të ardhurat e vëllait të subjektit të rivlerësimit nga punësimi gjatë periudhës 2006-2009, rezultojnë në vlerën 70.885,22 paund ose, të konvertuara në euro, 87.621,63 euro.

Sipas Eurostat, shpenzimet e jetesës për një person të vetëm për vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2009 janë në vlerën 45,494 euro. Duke qenë se llogaritë e vëllait të subjektit të rivlerësimit janë të përbashkëta me znj. A. H. dhe në dosje nuk gjendet informacion tjetër për përbërjen familjare të z. A. H., shpenzimet e jetesës u konsideruan për dy persona, pra në vlerën 90.988 euro.

20.7 Sa u përket të ardhurave të vëllait të subjektit nga kreditë konsumatore, rezultoi se kredia në vlerën 18.026 paund, e marrë në vitin 2007, ka pasur për qëllim financimin e blerjes së një automjeti. Kredia konsumatore në shumën 15.000 paund, e marrë nga vëllai i subjektit të rivlerësimit në vitin 2009, në dokumentacionin e administruar në dosje nuk mund të evidentohet ndonjë qëllim specifik i kësaj kredie, përveç përshkrimit si konsumatore. Kreditë konsumatore të marra nga vëllai i subjektit të rivlerësimit nuk mund të konsiderohen si pjesë e të ardhurave familjare me të cilat pretendohet krijimi i kursimeve me qëllim blerjen e banesës dhe dhurimin e shumave ndaj subjektit të rivlerësimit. Këto kredi rrisin shpenzimet familjare të vëllait të subjektit të rivlerësimit për shlyerjen e kësteve të tyre.

20.8 Në përfundim të analizës financiare të kryer në Kolegj për këtë shkak ankimi, rezulton se, sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e Komisionit dhe provat e marra në Kolegj, vëllai i subjektit të rivlerësimit nuk mund të përballonte njëkohësisht shpenzimet e tij të jetesës në Angli dhe të dërgonte dhuratë për subjektin e rivlerësimit shumë monetare prej 6.000 eurosh dhe 4.000 paund dhe të kontribuonte në financimin e shtëpisë, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar/pretenduar se vëllai i tij ka pasur burime të tjera të cilat nuk janë evidentuar. Për më tepër, nuk u provua as mënyra e sjelljes/ardhjes së këtyre shumave në vendin tonë, si dhe nga diferenca negative e rezultuar nga analiza financiare e kryer në Kolegj për subjektin e rivlerësimit për periudhën 2007-2009, e cila rezultoi në vlerën negative prej 188.550 lekësh, arrihet në konkluzionin se dhurimet nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si rrjedhojë rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit 84/2016, ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë *cash* të deklaruar në deklaratën *vetting*. *Sa më sipër, shkak i ankimit të Komisionerit Publik gjendet i bazuar.*

ii. Shkaqe ankimi dhe kundërankimi që lidhen me kriterin e aftësisë profesionale

21. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka bërë rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar, por jo vetëm, në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të tij të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme me raportin me nr. {***} prot., datë 03.07.2018, denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit 84/2016, si dhe kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016.
22. Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, rezulton se pas mbylljes së hetimit administrativ, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit dhe ONM-së janë depozituar disa denoncime nga publiku kundrejt subjektit të rivlerësimit, në lidhje me çështje penale të trajtuara nga ai. Si pasojë Komisioni, i mbledhur në datën 09.04.2019, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të rihapë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Besim Hajdarmataj për të hetuar më tej mbi këto denoncime. Referuar rezultateve të hetimit administrativ shtesë, Komisioni ka konstatuar disa mangësi për kriterin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, të tilla që për nga karakteri dhe përsëritja, bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, është parë e nevojshme nga Komisioni t'i kalojë subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për këto çështje/procedime penale të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës së tij, për të cilat Komisioneri Publik ka shtruar shkaqet e ankimit si më poshtë vijnë.
23. *Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit {***}*, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, në të cilën subjekti i rivlerësimit ka pasur rolin e drejtuesit dhe prokurorit që ka hetuar çështjen, Komisioneri Publik pretendoi se qëllimi i subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë hetimi i çështjes në mënyrë shteruese, për sa kohë janë anashkaluar një sërë veprimesh procedurale të nevojshme hetimore në zbardhjen e çështjes. Komisioneri Publik pretendoi gjithashtu se cilësimi i veprës dhe procedimi penal të regjistrohej për "Kundërshtim të punonjësit

që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik, e kryer në bashkëpunim", parashikuar nga neni 235/2 i Kodit Penal. Gjithashtu Komisioneri Publik pretendoi se, ndërmjet numrave telefonikë të subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit M. L., rezulton të jenë shkëmbyer mesazhe telefonike, dhe se nga të dhënat e sistemit TIMS, rezultojnë kalime të përbashkëta të kufirit shqiptar përmes aeroportit të Rinasit, duke realizuar fluturime në të njëjtën linjë dhe në të njëjtin destinacion, më shumë se një herë. Komisioneri Publik e gjen të pambështetur vendimin e Komisionit për transferimin e çështjes pranë organit kompetent, pasi nga vlerësimi i këtij rasti, ka elemente të mjaftueshme për një vlerësim të ndryshëm, bazuar në përcaktimet e nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

23.1 *Subjekti i rivlerësimit, në kundërrankimin që ka paraqitur ndaj ankimit të Komisionerit Publik, ka kundërshtuar me arsyetimin se konstatimet e këtij të fundit ku evidentohet moskryerje e veprimeve hetimore gjatë kohëzgjatjes së hetimit duke aluduar për "qëllimin e subjektit të rivlerësimit" që kjo çështje të mos hetohet, janë të tilla që ngrihen në nivelin e paragjyqimit, të pambështetur në të dhënat që rezultojnë nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni. Vlerësimi i njohurive ligjore të prokurorit nuk mund të bëhet duke iu referuar një çështjeje penale të vetme, por është një konkluzion që mund të arrihet vetëm duke vlerësuar një tërësi të dhënash, siç janë të dhënat statistikore tërësore, treguesit cilësorë, respektimi i afateve etj. Lidhur me kualifikimin ligjor të faktit për të cilin është regjistruar procedimi penal, analizën e provave, vlerën provuese të tyre, analizën për ekzistencën ose jo të elementeve të figurës së veprës penale dhe shkaqet e pushimit të procedimit penal, përbëjnë vlerësim mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes. Marrëdhënia e pretenduar në denoncimin anonim të publikut me z. M. L., është hetuar gjerësisht nga Komisioni gjatë hetimit administrativ. Pas hetimit të këtij pretendimi, Komisioni ka konkluduar se nuk ka të dhëna për ndikimin e subjektit të rivlerësimit nga ky shtetas në lidhje me procedimin penal nr. {***}, referuar më sipër.*

23.2 *Konkluzionet e Komisionit për këtë procedim penal: [...] subjekti ka vepruar në cilësinë e prokurorit të çështjes, trupi gjyqësor, për shkak të mangësive të konstatuara në dosjen penale, ka vlerësuar se këto mangësi mund të përbëjnë shkaqe për procedim disiplinor, bazuar në pikën 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, gjykon se kjo dosje duhet t'i transferohet organit kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.*

23.3 *Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se procedimi penal me nr. {***} është regjistruar nga subjekti i rivlerësimit si drejtues i prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, më datë 07.05.2010, për veprën penale "Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik" dhe "Vetëgjyqësia", parashikuar përkatësisht nga nenet 235/1 dhe 277 të Kodit Penal. Vepra penale është kallëzuar nga z. V. B., punonjës i Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (në vijim "NjMLF"), pranë komisariatit të rrethit Kurbin më 04.05.2010. Gjatë ushtrimit të kontrollit nga ana e tij dhe inspektorëve të kontrollit të këtij institucioni, janë sekuestruar pesë makineri lojërash fati të tipit "APEX" të përdorura për ushtrimin e lojërave të fatit në mënyrë të paligjshme në një ambient publik. Gjatë transportimit të pajisjeve të lojërave të fatit, me një mjet transporti të institucionit, për në Tiranë, grupi i kontrollit*

të Njësisë është ndaluar nga disa persona, të cilët kanë kërcënuar të gjithë zyrtarët e pranishëm dhe kanë vjedhur makineritë duke i ngarkuar në një kamion tjetër. Gjatë rrugës për në komisariatit e Kurbin, denoncuesi ka marrë një telefonatë nga M. L. nga një numër celulari, të cilin e ka deklaruar në deklaratën e dhënë për policinë (së bashku me numrin e telefonit), i cili e kishte paralajmëruar “të harronte punën e tij dhe të mos e raportonte ngjarjen në polici”, duke e kërcënuar se përndryshe “ai do të kishte pasoja”. Po i njëjti zyrtar ka raportuar se, pasi ka mbërritur në komisariatit e Kurbin, ka parë një kamion për të cilin ka treguar targën, ku ishin ngarkuar pesë kompjuter të vjetër, të cilët ishin sjellë për t’i zëvendësuar dhe ishin të ndryshëm nga ata të konfiskuar në Peshkopi, nga grupi i tij i kontrollit.

23.4 Nga aktet e administruara në dosje, rezulton se nga momenti i regjistrimit të procedimit penal në datën 07.05.2010, deri në momentin kur është vendosur pushimi i hetimeve, në datën 27.07.2011, pas më shumë se një viti, nga prokuroria nuk është kryer asnjë veprim tjetër procedural. Të vetmet veprime janë ato të kryera nga Komisariati i Policisë Kurbin. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka bërë vetëm vlerësimin e një sekuestroje më datë 06.05.2010, i cili ka vendosur vleftësimin e ligjshëm të sekuestros mbi provat dhe sendet e cituara në këtë akt. Në urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, në dispozitivin e aktit, në pikën 3, për kryerjen e veprimeve hetimore është urdhëruar Oficeri i Shërbimeve të Policisë Gjyqësore që ka përpiluar informacionin për referimin e veprës penale. Nuk ka urdhër delegimi dhe asnjë veprim të kryer pas regjistrimit të procedimit penal. Për këtë procedim, më 27.07.2011, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të pushojë hetimin, referuar gërmës “a” të nenit 328/1 të Kodit të Procedurës Penale, duke konkluduar se fakti nuk ekziston.

23.5 Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 24.04.2019, i ka kërkuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë informacion dhe vlerësim për këtë procedim penal dhe për të tjerët që do të trajtohen në vijim, ku KLP-ja, në përgjigjen e saj me nr. {***} prot., datë 27.05.2019, ka bërë analizën e procedimeve pasi i ka tërhequr fashikujt nga prokuroritë përkatëse. Lidhur me procedimin penal nr. {***}, i ka rezultuar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

23.6 Kolegji vëren se, nga aktet e hetimit administrativ, ka rezultuar se Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime, për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, paragrafin 5 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 73 të ligjit nr. 96/2016, pas të cilave subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e datës 04.10.2019, ka sqaruar se: *Lidhur me zvarritjen e vendimmarrjes, nuk ka pasur asnjë arsye tjetër përveç faktit se përgjatë këtij viti unë kam mbuluar një punë të konsiderueshme si prokuror në atë prokurori, duke hetuar dhe përfaqësuar në gjykim një numër të konsiderueshëm procedime sh penale, për vepra penale të rënda dhe shume sensitive për rrethin gjyqësor në fjalë [...]. Në fakt, në atë periudhë, kishte përhapje të gjerë të veprës penale të lojërave të fatit dhe kishte qendra lojërashfati kudo, ndaj është shumë e dyshimtë fakti që punonjës të NJMLF të udhëtonin deri në Dibër për të sekuestruar 5 makina kompjuterike. Punonjësit e NJMLF nuk kishin asnjë plan pune, për udhëtimin me shërbim në drejtim të qytetit Dibër, i cili do të dokumentonte udhëtimin e këtyre punonjësve për kontroll të aktivitetit të lojërave të fatit. Një dokument i tillë pasqyronte dhe ligjëronte faktin se*

këta punonjës ishin në kryerjen e një detyre shtetërore ose në shërbim publik [...]. Nëse ngjarja e marrjes me forcë e makinave kompjuterike ka ndodhur në të vërtetë, ndërkohë që ngjarja ishte duke ndodhur, kallëzuesi dhe secili nga punonjësit e NJMLF kishte mundësi të njoftonte edhe me telefon policinë vendore. Me marrjen e këtij informacioni, policia mund të merrte masa për kapjen në flagrancë të personave të kallëzuar, kontrollin e tyre etj. Marrja e kompjuterëve, siç përshkruhet nga kallëzuesi dhe punonjësit e NJMLF, pa asnjë lloj rezistence të tyre, e bënte këtë fakt të dyshimtë.

23.7 Kolegji konstaton nga aktet e administruara në fashikullin penal, se, sipas kallëzimit të kryer nga V. B., pas vjedhjes së kompjuterëve, ai është telefonuar nga M. L. dhe është kërcënuar në telefon, gjë për të cilën nuk u hetua më tej për sqarimin e rrethanave dhe zbardhjen e ngjarjes. Në vendimin e pushimit, subjekti i rivlerësimit vë në dyshim rrethanat e kallëzuara nga zyrtarët shtetërorë, arsyetim i cili nuk është bindës, pasi në këtë drejtim nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Nga fashikulli hetimor, nuk rezulton nëse kallëzuesi ka marrë dijeni efektivisht për vendimin e subjektit të rivlerësimit për pushimin e hetimeve. Ndaj vendimit për pushimin e hetimeve, nuk është ushtruar ankim. Gjithashtu, konstatohet se vendimi i pushimit është marrë nga subjekti i rivlerësimit më datë 27.07.2011 dhe dosja është arkivuar më datë 27.11.2011. Ndërkohë, shkresa përcjellëse e vendimit të pushimit drejtuar NjMLF-së, Tiranë, mban datën 17.01.2013, pra rreth një vit e gjysmë pasi është vendosur pushimi i hetimeve.

23.8 Subjekti i rivlerësimit, gjatë seancave publike në Kolegji, lidhur me këtë procedim penal, u shpreh ndër të tjera se: *Vendimi i pushimit të procedimit i është njoftuar NjMLF-së dhe vonesa e dërgimit të njoftimit të vendimit nuk më ngarkon mua me përgjegjësi, pasi dërgimi i njoftimit të akteve kryhet nga ana e punonjësit përgjegjës të administratës së institucionit. Pas dorëzimit të dosjes pranë punonjësit përgjegjës të administratës së prokurorisë, nuk ka qenë në përgjegjësinë time koha në të cilën punonjësit kanë përcjellë apo postuar njoftimet për subjektet përkatëse. Nëse shihet me vëmendje fashikulli hetimor, do të konstatohet lehtësisht se shkresat përcjellëse për të njoftuar vendimmarrjen e prokurorit janë të numërtuara në fashikullin hetimor. Pra, kam treguar gjithë kujdesin e duhur në këtë drejtim dhe e kam konsideruar të ezauruar detyrimin tim ligjor për të përpiluar vendimin përkatës, si dhe shkresën përcjellëse që u drejtohet personave përkatës për të ushtruar të drejtën e ankimit.* Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioneri Publik nuk mund të gjykojë nëse vendimi i pushimit të procedimit penal është i drejtë ose i gabuar, pasi një gjë të tillë e ndalon shprehimisht neni 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.

23.9 Kolegjit i rezulton se nga të gjitha rrethanat e konstatuara më sipër, si dhe nga dokumentacioni i administruar në dosje, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për këtë procedim penal, përveç atyre të kryera nga Komisariati i Policisë Kurbin në momentet e para sapo ka ndodhur ngjarja, të cilat gjenden në fashikullin e procedimit penal nr. {***}, të administruar në dosjen e Komisionit. Në këtë procedim penal, dukshëm ka shumë situata të pahetuara nga subjekti i rivlerësimit, të cilat duheshin sqaruar me pikënisje materialin kallëzues të shtetasit V. B. Rrethanat që ky shtetas ka referuar në kallëzimin e tij, nuk janë sqaruar dhe hetuar, megjithëse ekzistonin indiciet dhe personat që kishte referuar ky shtetas, të cilët nuk janë thirrur dhe as pyetur

nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet oficerit të policisë gjyqësore. Materiali i kallëzuar nuk është regjistruar për veprën penale të “Kundërshtimit të punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik, e kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 235/2 i Kodit Penal, siç indiciet nga veprimet e para hetimore referojnë, saktësisht nga procesverbalet për marrjen e të dhënave nga personat që kishin dijeni për veprën penale, referohet se ka qenë një numër i madh personash, të cilët kanë ndaluar kamionin e NjMLF-së Tiranë dhe kanë marrë pajisjet e konfiskuara. Nuk u bë verifikimi i kompjuterëve të vjetër të sjellë me kamionçinë në Komisaratin Kurbini me ata të cilët ishin konfiskuar në Peshkopi, për të cilët kallëzuesi kishte regjistruar numrat serialë në formularin e sekuestrimit dhe referoheshin se ishin të tjerë ata të konfiskuar.

23.10 Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit për të sqaruar lidhjen me z. M. L., i cili në përgjigjen e datës 21.02.2019, i është përgjigjur se: *Sa i përket shtetasit M. L., ju sqaroj se me këtë shtetas nuk kam asnjë lidhje, nuk kam donjë raport shoqëror dhe nuk kam pasur marrëdhënie familjare apo të tjera, thjesht e njoh si person.* Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik që subjekti i rivlerësimit ka pasur shkëmbime të mesazheve telefonike, Kolegji verifikoi dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ dhe nga qelizat e dërguara nga kompania e telefonisë së lëvizshme Vodafone, numri celular që i përket z. L., sipas referimit në materialin kallëzues të z. B. që inicioi procedimin penal nr. {***}, rezultoi se ka dërguar sms drejt numrit të subjektit të rivlerësimit në datën 27.07.2017, ora 22:03:33, si dhe një tjetër sms drejt numrit të subjektit të rivlerësimit në datën 27.07.2017, ora 22:03:34, pra në të njëjtën datë, orë, minutë, por një sekondë më vonë. Nuk rezultoi nga përmbajtja e këtyre qelizave, që subjekti i rivlerësimit të ketë kthyer mesazh apo telefonatë zanore drejt numrit të M. L.

23.11 Sa i përket pretendimit të Komisionerit Publik se subjekti ka udhëtuar me z. L., Kolegji konstatoi se nga verifikimi i dokumentacionit të ekstraktuar nga sistemi TIMS, administruar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit dhe M. L. rezultojnë në tri udhëtime në të njëjtin fluturim, për të cilat ndryshe nga udhëtimi me makinë, nuk mund të konkludohet me siguri se kanë udhëtuar bashkërisht, për sa kohë një linjë ajrore mund të ketë në bord dhjetëra apo qindra persona që udhëtojnë në të njëjtin destinacion. Komisioni i ka kërkuar informacion⁸ kompanisë {***}, për një fluturim me destinacion Frankfurtin në vitin 2016, nëse subjekti i rivlerësimit dhe z. L. i kanë pasur ndenjësjet e avionit ngjitur. Kompania ajrore {***} në përgjigjen e saj, datë 30.04.2019, i ka sjellë në vëmendje Komisionit se informacioni i kërkuar për udhëtarët, nuk mund të jepet në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale, duke mbetur kështu i pasqaruar fakti nëse subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkë me z. L. në këtë udhëtim apo destinacioni i përbashkët ka qenë një rastësi. Në kushtet kur Kolegji ishte në pamundësi për të kryer një vlerësim të thelluar në drejtim të udhëtimit të përbashkët të subjektit me individin në fjalë dhe të faktit që nuk përjashtohet në mënyrë bindëse edhe rastësia e gjendjes së subjektit të rivlerësimit me këtë individ në të njëjtin fluturim, por edhe ditët e ndryshme të njerit prej fluturimeve, trupi gjyqësor i Kolegjit konkludoi që ky pretendim nuk arriti nivelin e provueshmërisë.

⁸ Me shkresën nr. {***}, datë 19.04.2019.

23.12 Në përfundim të analizës së këtij shkakut ankimi, bazuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në drejtimin e veprimtarisë hetimore në funksion të zbardhjes së ngjarjes e vënies para përgjegjësisë ligjore të autorëve përkatës, si edhe ka pamundësuar ushtrimin e të drejtave të kallëzuesve për të ankimuar vendimin e marrë prej tij, sipas të cilit ka arritur në konkluzionin se fakti nuk ekziston. Si rrjedhojë, për të gjitha rrethanat e cituara më lart, të konstatuara në fashikullin penal, nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, shkakut i ankimit i ngritur nga Komisioneri Publik gjendet i bazuar në prova e në ligj.

24. *Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit {***}*, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (subjekti i rivlerësimit ka qenë në rolin e drejtuesit), të regjistruar mbi bazën e akteve të dërguara për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet për veprat penale të "Trafikimit të lëndëve narkotike të kryer në bashkëpunim", në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, si dhe "Pjesëmarrje në grupin e strukturuar kriminal", të parashikuar nga nenet 283, paragrafi 2, 333/a dhe 334, pika 1 e K.Penal, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit posaçërisht për shkak të detyrës funksionale që ushtronte si drejtues i Prokurorisë, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 97/2016, kishte të drejtën dhe detyrimin të verifikonte ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, në rastin konkret, mund të udhëzonte me shkrim, kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merrej vendim nga prokurori i çështjes mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake.

24.1 *Subjekti i rivlerësimit në kundërankim* ka kundërshtuar se në lidhje me kompetencat e drejtuesit të prokurorisë, sa i përket ushtrimit të ndjekjes penale, në nenin 43 të ligjit nr. 97/2016, përcaktohet kompetenca e kufizuar e drejtuesit të prokurorisë vetëm në kërkimin e informacionit për ecurinë e procedimeve, nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për prokurorët, gjatë ecurisë së hetimit dhe gjithashtu, sipas përcaktimeve të pikës "c" të nenit 43 më sipër, kur është e nevojshme, udhëzon me shkrim kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake.

24.2 Konkluzionet e Komisionit për këtë procedim penal: *Subjekti i rivlerësimit, si drejtues i prokurorisë, është nënshkrues i shkresës përcjellëse të vendimit të shpalljes së moskompetencës, datë 27.7.2017, marrë nga prokurori i çështjes, duke vepruar në respektim të ndryshimeve ligjore të miratuara, konkretisht të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", dhe udhëzimit nr. 2, datë 29.12.2016, "Për organizimin dhe koordinimin e punës në Prokurori" të Prokurorit të Përgjithshëm, të dalë në zbatim të tij, në respektim të pavarësisë dhe autonomisë së prokurorëve të çështjes. Trupi gjykues çmon se në çfarëdolloj rrethane të ngritjes së dyshimeve, apo fakteve të moskryerjes së hetimeve për këtë rast, duhet të konsiderohen në vlerësimin e subjektit tjetër të rivlerësimit, prokurorit të çështjes, si përgjegjësi e tij për hetime të plota dhe shteruese. Në konsideratë të faktit se në vlerësimin drejtë të situatës konkrete, ku roli i subjektit si drejtues nuk mund të ngarkohet apriori me elemente dyshimi të qëllimshme, trupi gjykues vlerëson se qëllimi duhet të provohet dhe jo të ngrihet mbi bazë hamendësimi.*

24.3 Kolegji konstaton se nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se në datën 08.04.2017, në dalje të fshatit {***}, Përmet, shërbimet e Policisë së Shtetit kanë gjetur dhe sekuestruar, në një magazinë pronë shtetërore, një sasi lënde narkotike *Cannabis Sativa*, me peshë totale 11.650 kg. Nga hetimet e kryera, ka rezultuar se personat e përfshirë në aktivitetin e posedimit të lëndës ishin shtetasit K. Z., E. A., I. S. dhe R. M.. Procedimi penal nr. {***} është regjistruar në datën 08.04.2017, në Prokurorinë Përmet, për kryerjen e veprës penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve", parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Prokurori i çështjes urdhëroi më datë 10.04.2017, që të përfshihen në regjistër veprat penale "Trafikim i lëndëve narkotike", "Grup i strukturuar kriminal", "Keqpërdorim i detyrës publike", "Mosraportim i një krimi", "Vjedhje e energjisë elektrike", parashikuar nga nenet 283/a/2/3, 333/a, 248, 300 dhe 137 të Kodit Penal. Prokurori i çështjes urdhëroi gjithashtu të regjistrojnë emrat e personave nën hetim, K. Z., E. A., I. S. dhe R. M..

Pas kryerjes së veprimeve të mësipërme, prokurori i çështjes, më datë 11.04.2017, vendosi të shpallë moskompetencën lëndore për çështjen dhe transferimin e akteve të procedimit penal nr. {***} në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Arsyetimi i dhënë në vendim ishte që: *[...] bazuar në faktet dhe provat e administruara deri në atë fazë të hetimit, u vu re se personat e përfshirë në veprimtarinë kriminale demonstuan një pjesëmarrje të qëndrueshme në grupin kriminal, dhe se ekzistonte një ndarje e detyrave midis tyre dhe bashkëpunim në nivelin e grupit të strukturuar kriminal.*

24.4 Më tej, konstatohet se në datën 14.04.2017, aktet e procedimit penal {***}, nga Prokuroria e Përmetit kalojnë në Prokurorinë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, Tiranë dhe çështja iu caktua prokurorit D. P.. Ai vendosi më datë 15.04.2017, të pranojë dokumentet zyrtare dhe të regjistrojë procedimin penal nr. {***} ndaj shtetasve nën hetim. Gjykata e Shkallës së Parë e Krimeve të Rënda miratoi më 03.05.2017, vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet dhe caktoi masën e sigurimit "arrest me burg", të parashikuar nga 238 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasve nën hetim. Në këtë procedim penal, janë kryer disa veprime hetimore, siç janë përgjimet telefonike, administrimi i të dhënave të siguruar nga kompanitë e telefonisë celulare, administrimi i dokumenteve zyrtare, marrja në pyetje e personave të cilët kishin dijeni për rrethanat e veprave penale etj. Më datë 27.07.2017, prokurori i çështjes vendosi të shpallë moskompetencën lëndore dhe të transferojë dokumentet e procedimit penal nr. {***} sërish në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet. Sipas arsyetimit të këtij vendimi, nuk është konfirmuar ndonjë element bashkëpunimi midis të dyshuarve në kuadrin e grupit të strukturuar kriminal, nuk është arritur ndonjë marrëveshje specifike lidhur me rolet e tyre në kryerjen e veprave penale dhe nuk ka rezultuar të jetë krijuar ndonjë strukturë specifike kriminale për të kryer veprat penale të sipërpërmendura. Lidhur me zgjidhjen e kësaj çështjeje, që është moskompetenca dhe kalimi i akteve sërish në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, drejtuesi i Prokurorisë për Krime të Rënda (subjekti i rivlerësimit) ka firmosur shkresën përcjellëse për transferimin e procedimit penal nr. {***}, duke konfirmuar kështu dijeninë nga ana e tij për këtë transferim.

24.5 Nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal nga Komisioni, është vërejtur se hetimi dhe vlerësimi i veprave penale të regjistruara në Prokurorinë e Krimeve të Rënda është përqendruar në

të pandehurit që janë kapur në vendin e ngjarjes dhe nuk është kryer asnjë hetim në mënyrë që të evidentohet se kush ishin organizatorët e këtij aktiviteti. Mbledhja dhe paketimi i 11.650 kg kanabis me vlerë të konsiderueshme, e cila kishte qenë në atë ambient për një periudhë të konsiderueshme kohe para se të kapej, ishte e dukshme që ishte për qëllim trafikimi ndërkombëtar dhe kërkonte një lloj organizimi ku të përfshinte një numër të madh personash. Prokuroria për Krimet e Rënda nuk kishte kryer një hetim proaktiv për të identifikuar anëtarët e drejtues të grupit të strukturuar kriminal, të cilët po drejtonin një operacion shumë të madh të trafikut të lëndës narkotike. Duke vepruar kështu, Prokuroria për Krimet e Rënda ka injoruar provat e shumta të gjetura për të ngarkuar me përgjegjësi penale individë të përfshirë në këtë aktivitet si bashkëpunëtorë ndaj një grupi të strukturuar kriminal. Nga shqyrtimi i akteve, Komisioni evidentoi nevojën e kryerjes së një sërë veprimesh hetimore të cilat duhet të ishin kryer.

24.6 Nga të gjitha konstatimet e përmendura më sipër, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime, për të provuar të kundërtën, pas të cilave subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e datës 04.10.2019, ka sqaruar se: *[...] Ndërkohë ju shpjegoj se ndryshimet ligjore të Kodit të Procedurës Penale ishin miratuar dhe hyrja në fuqi ishte çështje ditësh, por risqarojmë se kohë më parë kishte hyrë në fuqi ligji me nr. 97/2016. Me hyrjen në fuqi të ligjit me nr.97/2016, si dhe bazuar në udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, kompetencat e prokurorit më të lartë në ushtrimin e ndjekjes penale për çështje konkrete gjenin vend vetëm sa i përket fazës së hetimeve, ndërkohë që akoma nuk është marrë një vendim nga prokurori i çështjes. Edhe në fazën e hetimeve, udhëzimi i prokurorit më të lartë nuk është i detyrueshëm, ku edhe në këtë rast prokurori gëzon autonomi të plotë në orientimin e hetimeve.*

24.7 Kolegji vëren se, nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se në Prokurorinë për Krime të Rënda, më datë 27.07.2017, prokurori D. P. ka vendosur të shpallë moskompetencën lëndore dhe kalimin e akteve të procedimit penal {***} sërish Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka dërguar shkresën me nr. {***} prot., datë 28.07.2017, më lëndë “Dërgohet për kompetencë lëndore dhe tokësore procedimi penal nr.”, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, duke mos ushtruar kompetenca që ligji ia jep për të udhëzuar veprime të mëtejshme, si dërgimin e kësaj çështjeje për vazhdimin e veprimeve hetimore në Prokurorinë e Përmetit.

24.8 Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegji, subjekti i rivlerësimit sqaroi lidhur me këtë procedim penal se: *Cilësimi juridik i faktit penal është detyrë dhe përgjegjësi e prokurorit të çështjes dhe gjykatës në vendimin përfundimtar, jo e drejtuesit të Prokurorisë. Por, pavarësisht kësaj, shkakun i kalimit për kompetencë të kësaj çështjeje në Prokurorinë për Krime të Rënda, nuk ishte përfshirja e personave të arrestuar, por sasia e lëndës narkotike. Prokurori i çështjes në Prokurorinë për Krimet e Rënda, nga hetimet që bëri, konkludoi se personat e arrestuar nuk kishin asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me lëndën narkotike, dy prej të cilëve ishin elektrikisti i zonës dhe kryetari i fshatit. Për rrjedhojë, kalimi për kompetencë nuk ka lehtësuar aspak pozitën procedurale në raport me akuzën ndaj këtyre personave. Po ashtu, nuk kishte asnjë të dhënë ose informacion nga policia e*

shtetit apo organet e tjera ligjzbatuese për personat e përfshirë në këtë aktivitet të kundërligjshëm dhe prokurori i çështjes, brenda një kohë të arsyeshme, procedoi me shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet. Sa i përket hetimit, policia e shtetit, e cila mori një informacion të vlefshëm për vendndodhjen e kësaj lënde narkotike, nuk e menaxhoi mirë rastin dhe nuk duhej të lëvizte lëndën narkotike, si dhe ta bënte publik rastin, por duhet të njoftonte prokurorinë e juridiksionit ku u gjet dhe u sekuestrua lënda narkotike ose Prokurorinë për Krime të Rënda, ndërsa nuk ndodhi kjo, hetimi i kësaj çështjeje në drejtim të dokumentimit të autorësisë së veprës penale, u bë i vështirë dhe i pamundur.

24.9 Kolegji konstatoi se, nga tërësia e veprimeve të mësipërme të konstatuara nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit është përfshirë në këtë çështje nëpërmjet përcjelljes së fashikullit hetimor dhe vendimit të moskompetencës të marrë nga prokurori i çështjes i ngarkuar për kryerjen e veprimeve hetimore. Në nenin 43 të ligjit nr. 97/2016, ku parashikohen kompetencat e drejtuesit të prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale, shkronja “b” parashikon: *Drejtuesi i prokurorisë ka këto kompetenca në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale: [...] kërkon informacion për ecurinë e procedimeve dhe, nëse është e nevojshme, nxjerr udhëzime me shkrim, sipas këtij ligji, si dhe shkronja “ç” e po këtij neni parashikon: “verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, kur është e nevojshme, udhëzon me shkrim, sipas nenit 48 të këtij ligji, kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprahe.* Në fashikullin e procedimit penal me nr. {***}, nuk vërehet asnjë udhëzim me shkrim apo kërkim informacioni nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të prokurorit të ngarkuar për hetimin e çështjes penale; një gjë e tillë nuk është pretenduar as nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, nuk rezultojnë udhëzime për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale, edhe pse disa veprime hetimore ishin kryer në Prokurorinë për Krime të Rënda. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit pretendoi se udhëzimet e drejtuesit të prokurorisë nuk janë të detyrueshme në funksion të autonomisë së prokurorit të çështjes, një veprim i tillë nuk rezulton të jetë ndërmarrë për të garantuar kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale, çka do të thotë se, megjithëse udhëzimet nuk janë të detyrueshme për prokurorët, nuk nënkupton që subjekti i rivlerësimit të mos ushtrojë kompetencat që i njeh ligji në drejtim të eficiencës së këtyre hetimeve.

24.10 Në përfundim të analizës më sipër, Kolegjit i rezultoi se koha shumë e shkurtër e hetimit konfirmon më tej mungesën e angazhimit për të ndjekur penalisht strukturën kriminale në tërësinë e veprimeve të saj. Përkundrajt një vlerësimi të arsyeshëm të fakteve dhe logjikës, prokurori i çështjes përjashtoi përfundimisht ekzistencën e ndonjë elementi të krimit të organizuar apo sjellje që mund të kualifikoheshin si trafikim i narkotikëve, duke e nxjerrë kështu veprimtarinë kriminale jashtë rrethit të veprave penale që parashikon neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, nëpërmjet transferimit të dosjes në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Nga tërësia e rrethanave, u konstatua se mosveprimi i subjektit të rivlerësimit në drejtim të udhëzimeve për ecurinë e procedimit penal, tregon mosrespektim të detyrimeve që i njeh ligji, si dhe mosangazhim ndaj vlerave profesionale, duke vlerësuar që çështja në fjalë ishte e një rëndësie të tillë (e karakterizuar nga një konfiskim i madh i kanabisit në Shqipëri) që kërkonte mbikëqyrje nga

subjekti i rivlerësimit, në ushtrimin dhe përmbushjen e detyrave të tij ligjore. *Shkaku i ankimit i ngritur nga Komisioneri Publik, gjendet i bazuar.*

25. *Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit {***}, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (subjekti ka qenë në rolin e drejtuesit), Komisioneri Publik pretendoi se vendimi për zëvendësimin e prokurorit nga ana e subjektit të rivlerësimit, është pjesërisht i argumentuar dhe nuk gjen mbështetje ligjore, referuar nenit 27 të Kodit të Procedurës Penale. Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nuk është kryer asnjë lloj hetimi lidhur me nivelet më të larta të organizatës kriminale, duke përfshirë këtu dhe z. B. P., në periudhën pas konfiskimit të drogës, për afro dy vite. Ndërkohë, gjatë gjithë kësaj periudhe, nuk rezultoi e provuar që subjekti të ketë komunikuar me prokurorin e çështjes, të jetë përpjekur të informohet apo të adresojë problematikat. Komisioneri Publik pretendoi se në këtë çështje të një rëndësie madhore, nisur nga sasia e madhe e lëndës narkotike, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, nuk ka ushtruar plotësisht detyrat e tij funksionale.*

25.1 *Subjekti i rivlerësimit në kundërankim, lidhur me këtë procedim penal, ka kundërshtuar se pas marrjes së vendimit nga prokurori i çështjes, ka pasur pamundësi ligjore të veprojë, duke respektuar autonominë dhe pavarësinë e prokurorit në lidhje me hetimin e çështjes. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, se është i paargumentuar dhe i pabazuar në ligj, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ndërhyrja nëpërmjet zëvendësimit të prokurorit ka ardhur pikërisht në ushtrim të detyrave ligjore për mbikëqyrjen e ecurisë së hetimeve, detyra të cilat Komisioneri Publik konkludon se subjekti nuk i ka ushtruar. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ka qenë zvarritja e procedimit penal dhe kohëzgjatja e tij që ka passjellë zëvendësimin e prokurorit të çështjes me një grup të përbërë nga dy prokurorë të tjerë, arsye kjo e pasqyruar qartë në arsyetimin e vendimit për zëvendësimin e prokurorit, si shkaku kryesor i kësaj vendimmarrjeje. Zëvendësimi i prokurorit është bërë në përputhje me parashikimet e nenit 27, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 45, pika 2 e ligjit nr. 97/2016 dhe ka pasur qëllim të vetëm atë të përcaktuar në aktin e zëvendësimit, për të garantuar zhvillimin e hetimeve të cilat, siç rezultojnë nga kohëzgjatja dhe ecuria e procedimit, nuk kishin ecur në rrugën dhe dinamikën e duhur.*

25.2 *Konkluzionet e Komisionit për këtë procedim penal: Subjekti i rivlerësimit, si drejtues i prokurorisë, është nënshkruar i shkresës përcjellëse të vendimit të shpalljes së moskompetencës marrë nga prokurori i çështjes, duke vepruar në respektim të ndryshimeve ligjore të miratuara, konkretisht të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimit nr. 2, datë 29.12.2016, “Për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, të dalë në zbatim të tij, në respektim të pavarësisë dhe autonomisë së prokurorëve të çështjes, trupi gjykues ka çmuar se nuk mund ta ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në funksionin e drejtuesit.*

25.3 *Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultojnë se në datën 16.11.2013, në Prokurorinë për Krime të Rënda është regjistruar çështja penale nr. {***}, për veprën penale të*

parashikuar nga neni 283/a, paragrafi i dytë i Kodit Penal. Nga fashikulli i procedimit penal, rezulton se në datën 30.09.2015 dhe në datën 01.10.2015, në rrethinat e {***}, Shkodër, shërbimet e policisë kufitare, në bashkëpunim me shërbimet e Guardia di Finanza, kanë gjetur e sekuestruar çanta me lëndë narkotike *Cannabis Sativa*, me peshë totale, përkatësisht 201,5 kg dhe 579 kg. Veprimet hetimore të karakterit teknik, si përgjime telefonike dhe vëzhgime në terren, janë konkretizuar me arrestimin e shtetasve M. H., E. S., I. Rr., L. Dh., M. V. dhe K. C., të cilët janë dërguar për gjykim për kryerje të veprës penale “Trafikimi i narkotikëve”, parashikuar nga nenet 238/a, paragrafi i dytë dhe 22 të Kodit Penal. Në datën 28.10.2015, janë ndarë aktet në ngarkim të të pandehurve M. H., E. S., I. Rr., L. Dh., M. V. dhe K. Ç., të cilët janë dërguar për gjykim për kryerje të veprës penale "Trafikimi i narkotikëve", parashikuar nga nenet 283/a/2 e 22 të Kodit Penal. Nga hetimet e kryera, ka rezultuar se për faktin penal kanë pasur dijeni edhe shtetasit B. P., Gj. C. dhe P. Rr.. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka konkluduar se këta shtetas kanë konsumuar elementet e veprës penale “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, duke shpallur moskompetencën për hetimin e kësaj vepre penale dhe procedimin e të dyshuarve dhe duke i kaluar aktet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër.

25.4 Nga aktet e administruara në dosje, Kolegji konstatoi se në datën 08.05.2017, drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Besim Hajdarmataj, ka vendosur të zëvendësojë prokurorin B. D. për kryerjen e hetimeve të çështjes penale nr. {***}. Shkaku i zëvendësimit arsyetohet me zvarritjet në hetim, ku konstatohet nga drejtuesi një periudhë 1-vjeçare pa kryer veprime hetimore, si dhe i referohet faktit të krijimit të seksioneve që hetojnë grup-vepra penale të caktuara, ku prokurori B. D. rezulton të jetë caktuar në një seksion që nuk heton veprat penale në fushën e trafikimit të narkotikëve, por edhe kishte pasur një ngarkesë të lartë pune. Në këto kushte, drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur zëvendësimin e prokurorit të çështjes dhe hedhjen në short në seksionin përkatës për të caktuar prokurorin që do të hetojë çështjen.

25.5 Komisioni, në analizë të fashikullit të procedimit penal, ka konstatuar se nga ana e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, nuk është kryer asnjë lloj hetimi lidhur me nivelet më të larta të organizatës, duke përfshirë B. P. (por pa u kufizuar vetëm te ky shtetas), në periudhën pas konfiskimit të drogës, për afro dy vite. Gjithashtu nga Komisioni u konstatua se cilësimi juridik që është propozuar nga prokurori i Krimeve të Rënda në fund të hetimit, duket i gabuar, pasi në bazë të rezultateve të hetimit paraprak dhe masës së tij të arrestit, është pranuar që B. P. ka qenë në dijeni që ishte planifikuar veprimtari trafikimi në rrugën që po ndërtohej, ka kontribuar në ndërtimin e rrugës nga një pozitë e lartë, si dhe disa nga bisedat telefonike që janë përmendur nga gjyqtari në gjykimin për caktimin e masës së sigurimit, tregojnë se edhe B. P. ka qenë ndër furnizuesit e lëndëve narkotike.

25.6 Për shkak të konstatimeve në paragrafin më sipër, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime, për të provuar të kundërtën, pas të cilave subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e datës 04.10.2019, ka sqaruar se: *Indodhur para rrethanave kur për*

disa herë radhazi i kërkoja informacion prokurorit për arsyet e zvarritjes së hetimeve, si dhe vënien në lëvizje të veprimeve, duke mos marrë asnjë përgjigje, kam vendosur për zëvendësimin e prokurorit. Vendimi i zëvendësimit të prokurorit kishte argument kryesor zvarritjen e theksuar të hetimeve ose, e thënë ndryshe, shkëputjen e hetimeve për një kohë të gjatë, të pajustificuar, më shumë se një vit. Argumenti për krijimin e seksioneve dhe ngarkesave të prokurorit në punë, ishin dy konstatime të cilat nuk ishin shkak kryesor për zëvendësimin e prokurorit. Për shkak se kjo çështje kërkonte intensitet dhe shpejtësi të veprimeve hetimore, por edhe në marrjen e masave ndaj autorëve të dyshuar të veprave penale, për rrjedhojë janë caktuar dy prokurorë, të cilët kanë vijuar kryerjen e hetimeve dhe kanë proceduar me kërkesa në gjykatë për caktimin e masave të sigurimit për disa persona. Së pari, me cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, nuk kisha mundësi të evidentoja në një periudhë të shpejtë, secilin nga procedimet penale të cilat kishin problematika në zvarritjen e hetimeve. Pasi kam marrë informacion të plotë nga Oficeri i Policisë Gjyqësore dhe prokurori për ecurinë e hetimeve dhe nuk kam gjetur një reagim nga prokurori për vënien në lëvizje të veprimeve, kam vendosur zëvendësimin e tij nga hetimi i mëtejshëm i çështjes. Zëvendësimi i prokurorit ka ardhur pikërisht pas këtyre konstatimeve. Së dyti, sa i përket qëndrimit kontradiktor të miratimit të shkresave për kërkesat për caktim mase sigurimi dhe të nënshkrimit të shkresës për transferimin e procedimit penal, që nënkupton miratimin e kërkesave dhe vendimit të prokurorëve, roli i drejtuesit të prokurorisë ka qenë në respektim të plotë të pavarësisë dhe auto nomisë së prokurorëve të çështjes.

25.7 Nga të gjitha rrethanat e rezultuara në fashikullin penal të administruar nga Komisioni, se nga data e mbajtjes së pozicionit të drejtuesit (mars 2016) në Prokurorinë për Krime të Rënda të subjektit të rivlerësimit deri në momentin e vendimmarrjes (më datë 08.05.2017) për zëvendësimin e prokurorit që ishte caktuar për kryerjen e hetimeve të procedimit penal, rezultoi se ka kaluar më shumë se një vit që nuk ishin kryer hetime dhe subjekti i rivlerësimit nuk nxori asnjë udhëzim për ecurinë e hetimeve për prokurorin e çështjes deri në zëvendësimin e tij, madje duke ditur që ky procedim penal kishte filluar që nga viti 2013. Në nenin 27, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, “Rastet e zëvendësimit të prokurorit” (pa ndryshimet e ligjit nr. 35/2017) parashikohet: *Drejtuesi i prokurorisë vendos zëvendësimin e prokurorit kur ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën, si dhe në rastet e parashikuara në nenet 16 dhe 17 paragrafi i parë shkronjat “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh”. Në rastet e tjera prokurori zëvendësohet vetëm me pëlqimin e tij. Vetë subjekti i rivlerësimit, në vendimin e zëvendësimit të prokurorit, i ka trajtuar serioze arsyet për të cilat po zëvendësohet prokurori në hetimet e procedimit penal nr. {***}.*

25.8 Subjekti i rivlerësimit në bisedimet përfundimtare në Kolegj, lidhur me këtë procedim penal, parashtroi se: *Për këtë procedim penal, janë hetuar një numër i konsiderueshëm personash të përfshirë në trafikun e narkotikëve ku për 12 nga të pandehurit, në periudhat e ndryshme janë veçuar aktet dhe janë dërguar për gjykim në Gjykatën për Krimet e Rënda, ku pjesa më e madhe e tyre rezulton se janë drejtuesit e këtij aktivitetit të kundërligjshëm. Për këta të pandehur, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. {***}, datë 18.05.2016, i gjeti fajtorë të pandehurit dhe i dënoi me 77 vjet burgim në total, dhe po ashtu edhe Gjykata e Apelit për Krime*

të Rënda i dënoi të pandehurit me 81 vite burgim në total, duke i shtuar masat e dënimit për dy të pandehur. Dua të sqaroj se çështja asnjëherë nuk është transferuar në tërësi në Shkodër, dhe për krerët e organizatës siç pretendohet, por për individë të caktuar, për të cilët prokurorët pasi kishin bërë hetime të plota, evidentuan se nuk kishin prova të mjaftueshme për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike dhe është bërë veçimi i akteve dhe kalimi për kompetencë prokurorive, për veprat penale në kompetencën e tyre lëndore dhe tokësore.

25.9 Kolegji vëren se për këtë procedim penal, hetimet e prokurorisë kishin mangësi serioze të renditura me detaje në gjetjet e Komisionit, veçanërisht në lidhje me hetimin e dështuar për nivelet e larta të strukturës kriminale, dhe se subjekti i rivlerësimit dështoi të përmbushte detyrat e tij mbështetëse dhe mbikëqyrëse në lidhje me këtë çështje. Subjekti i rivlerësimit, në periudhën kohore nga marsi 2016 deri më 26 nëntor 2016, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 97/2016, ka pasur kompetenca të plota veprimi mbi çështjen. Në cilësinë e drejtuesit, subjekti vetëm pas një viti ka vendosur të zëvendësojë prokurorin e ngarkuar, me argumentimin që ka konstatuar zvarritje të hetimeve dhe nevojën për ecurinë e tyre, por nga ana tjetër, duke arsyetuar se prokurori i çështjes nuk i përkiste seksionit të veprave penale të fushës së trafikimit të narkotikëve, megjithëse sikurse ka pranuar në parashtrimet e tij para Komisionit, ka qenë i vetëdijshëm për seriozitetin, problematikat dhe rëndësinë e çështjes.

25.10 Në përfundim të analizës më sipër, rezultoi se mosveprimi i subjektit të rivlerësimit në drejtim të udhëzimeve për ecurinë e procedimit penal, tregon mosrespektim të detyrimeve që i njeh ligji, si dhe mosangazhim ndaj vlerave profesionale, duke vlerësuar që çështja në fjalë ishte e një rëndësie të tillë që kërkonte mbikëqyrje nga subjekti i rivlerësimit, në ushtrimin dhe përmbushjen e detyrave të tij ligjore. *Shkaku i ankimit i ngritur nga Komisioneri Publik, gjendet i bazuar.*

26. *Lidhur me procedimin penal nr. {***}, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ku në përfundim të hetimeve, është vendosur dërgimi për kompetencë i procedimit penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, Komisioneri Publik pretendoi se ka pasur mangësi në hetimin e çështjes pasi për nga sasia e drogës së sekuestruar, personave të përfshirë dhe mangësive të konstatuara, nuk duket bindës ndryshimi i cilësimit të veprave penale nga ana e subjektit të rivlerësimit. Nuk rezulton që të jenë dokumentuar hetime mbi lëvizjet financiare të të dyshuarve apo të jenë monitoruar telefonatat e tyre, me qëllim identifikimin e personave të tjerë të implikuar apo të konkludohej nëse rasti kishte karakter ndërkombëtar. Fakti që gjykata dënoi të pandehurit për një vepër penale të një rrezikshmërie më të ulët, si "Prodhim dhe shitje e bimëve narkotike", ashtu siç argumenton ndër të tjera dhe subjekti, nuk justifikon mungesën e hetimeve nga ana e prokurorisë, pasi gjykatës nuk iu vu në dispozicion asnjë element apo provë tjetër në bazë të së cilës, ajo mund të vendoste ndryshe. Komisioneri Publik vlerëson se qëndrimi dhe argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit nuk janë bindëse dhe të bazuara.*

26.1 *Subjekti i rivlerësimit në kundërrankimin e tij, lidhur me këtë procedim penal, ka pretenduar se për deklarimin e moskompetencës lëndore më datë 31.05.2016, ka vepruar sikurse rezulton nga aktet e dosjes dhe konkluzionet e Komisionit, në cilësinë e prokurorit më të lartë, në referim të*

parashikimeve të nenit 25, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, në të cilën parashikohet se: "Prokurori më i lartë ka të drejtë të ushtrojë kompetencat e prokurorit më të ulët". Në lidhje me konstatimet që kanë të bëjnë me themelin e vendimmarrjes dhe shkaqet e deklarimit të moskompetencës, rezulton se ato janë parashtruar të plota në vendimin përkatës të datës 31.05.2016 dhe janë shpjeguar përsëri prej tij, pasi ka limit të barrës së provës, nëpërmjet shpjegimeve të dërguara me shkrim më datë 04.10.2019. Arsyet e vendimmarrjes të parashtruara gjatë hetimit administrativ, mbështeten plotësisht në arsyetimin e vendimit për shpalljen e moskompetencës dhe analizën e fakteve dhe rrethanave që kishin rezultuar deri në atë moment të procedimit.

26.2 Konkluzionet e Komisionit për këtë procedim penal: *Vendimi për shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 31.5.2016, i përpiluar nga drejtuesi i prokurorisë, z. Besim Hajdarmataj, është hartuar nga ana formale në përputhje me ligjin procedural penal, bazuar në nenin 25/2 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohej shprehimisht se prokurori më i lartë ka të drejtë të ushtrojë kompetencat e prokurorit më të ulët. Vlerësimet dhe konstatimet e paraqitura nga Komisioni u referohen hetimeve shteruese që duhet të ishin kryer për këtë çështje, të cilat i përkasin prokurorit të çështjes.*

26.3 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i fashikullit penal të administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se në datën 25.09.2015, oficeri i policisë gjyqësore i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka përpiluar një informacion për referimin e veprës penale të dyshuar "Trafikim i narkotikëve", parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal. Informacioni bazohej mbi të dhëna të siguruara nga burime konfidenciale të datës 22.09.2015, për një aktivitet kriminal që po kryhej prej muajit qershor 2015 për grumbullimin me qëllim trafikimin e lëndës narkotike *Cannabis Sativa* nga disa të dyshuar. Referuar dosjes penale, nga hetimet e kryera, ka rezultuar se i pandehuri Q. Xh. siguronte lëndë narkotike *Cannabis Sativa*, të papërpunuar, në fshatrat e Krujës. Në banesën e tij është sekuestruar një sasi prej 668 kg e 337 gr. *Cannabis Sativa* dhe janë arrestuar në flagrancë personat e dyshuar. Sipas udhëzimit të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, materiali i është caktuar për veprime të mëtejshme prokurorit G. T., i cili në datën 25.09.2015, ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, për veprën penale të dyshuar "Trafikim i lëndëve narkotike", parashikuar nga neni 283/a, paragrafi 2 i Kodit Penal. Hetimet ndaj personave të dyshuar kanë vazhduar në kuadër të kryerjes së veprave penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" më shumë se një herë, në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283, paragrafi 2 e 28, pika 4 e Kodit Penal, "Krijimit të grupit të strukturuar kriminal", parashikuar nga neni 333/a i Kodit Penal dhe "Kryerjes së veprave nga grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga neni 334 i Kodit Penal. Prokurori i çështjes ka vendosur dy herë zgjatjen e afatit të hetimeve, me vendimin e datës 15.01.2016, për një afat tremujor dhe, me vendimin e datës 15.04.2016, për një afat dymujor, për shkak të nevojës së kryerjes së veprimeve hetimore që lidhen me njoftimin e akuzave, pyetjen e të pandehurve dhe përfundimin e hetimeve.

26.4 Kolegji vëren se nga aktet e dosjes, rezulton se në datën 31.05.2016, është vendosur shpallja e moskompetencës lëndore dhe kalimi i akteve të procedimit penal nr. {***} Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, si prokuroria që ka kompetencën lëndore dhe tokësore. Akti është përpiluar nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, subjekti i rivlerësimit Besim Hajdarmataj. Në vendim arsyetohen dispozitat e neneve 25 dhe 28 të Kodit Penal, të cilat japin kuptimin e bashkëpunimit dhe dallimin me bashkëpunimin e veçantë siç është në formën e grupit të strukturuar kriminal, në të cilin bëjnë pjesë dy ose më shumë persona, për kryerjen e një apo më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale. Në vendim arsyetohet se grupi i strukturuar kriminal paraqitet si një formë e veçantë bashkëpunimi, që kërkon një organizim dhe strukturim të caktuar minimal i cili nënkupton që midis anëtarëve të grupit të ekzistojë një ndarje rolesh dhe detyrash minimale, duke e konsideruar kështu rastin si bashkëpunim i thjeshtë ndërmjet të hetuarve, sipas kuptimit të nenit 25 të Kodit Penal. Nga aktet e administruara në dosje, konstatohet se nuk ka vendim zëvendësimi dhe se veprimet hetimore janë ndjekur nga prokurori G. T.. Ndërsa vendimi i shpalljes së moskompetencës në datën 31.05.2016, është përpiluar nga drejtuesi i Prokurorisë Besim Hajdarmataj. Nuk rezulton të ketë në fashikull akt që argumenton arsyen, përse vendimi i moskompetencës është përpiluar nga drejtuesi i institucionit.

26.5 Komisioni konstatoi nga shqyrtimi i akteve të dosjes, se hetimet e kryera janë fokusuar vetëm te personat e kapur në flagrancë në vendngjarje. Nuk rezulton që të jenë kryer veprime të mëtejshme hetimore nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, për të verifikuar nëse ka pasur persona të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet. Nga hetimi i kryer nga prokuroria, nuk u arrit të zbardhej dhe të konkludohej se cili ishte destinacioni i sasisë së lëndës narkotike të gjetur që do të trafikohesh, ndaj për këtë Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për të dhënë shpjegime dhe për të provuar të kundërtën, pas së cilës subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e datës 04.10.2019, ka sqaruar se: *Së pari rezultonte se ishin bërë hetime për një periudhë mbi shtatë muaj, dhe ishin zgjatur afatet e hetimeve me dy vendime zgjatje, njëra me tre muaj dhe tjetra me dy muaj e megjithatë nuk kishte akoma një zgjidhje, ndërkohë që zgjatja e afatit dymujor ishte e paargumentuar për veprime hetimore konkrete. Për shkak se aktiviteti i kundërligjshëm në këtë çështje ishte zhvilluar për një periudhë të shkurtër, nuk kishte dinamikë hetimesh. Së dyti, kam evidentuar se për njërin nga personat nën hetim, ndërkohë që nuk kishte përfunduar hetimi për t'i dhënë zgjidhje çështjes, ishin pushuar hetimet, çfarë nënkuptonte se hetimi për këtë procedim duhet të ishte i përfunduar, referuar kësaj zgjidhjeje. Zgjatja e hetimeve e datës 15.04.2016 ishte e paargumentuar dhe i referohej kryerjes së veprimeve procedurale me të pandehurit, e megjithatë nuk ishte kryer asnjë veprim në këtë drejtim. Së treti, kam konstatuar se prokurori, me fillimin e procedimit penal, e ka cilësuar faktin si vepër penale të trafikimit të narkotikëve, parashikuar nga neni 283/a/2 i K.Penal, vepër penale e cila ishte në kompetencë të Prokurorisë për Krime të Rënda. Më pas, me ndërhyrjen e policisë në shtëpinë(vilën) ku është gjetur lënda narkotike dhe është bërë arrestimi në flagrancë i të dyshuarve, vepra penale e trafikimit të narkotikëve ka rënë, pasi tashmë ishte larg çdo elementi trafikimi. Në këtë situatë, prokurori i çështjes i ka dhënë faktit cilësim tjetër juridik, duke i cilësuar faktet, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", e kryer në*

formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 283/2 dhe 333/a i K.Penal. Zgjidhja e bërë nga prokurori për të regjistruar veprën penale të kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, është bërë për të vazhduar kompetencën e Prokurorisë për Krime të Rënda për këtë çështje, pasi mungesa e kësaj vepre tashmë e nxirte jashtë juridiksioni Gjykatën për Krime të Rënda (neni 751a i Kodit të Procedurës Penale.

26.6 Subjekti i rivlerësimit gjatë seancave në Kolegj lidhur me këtë procedim penal, parashittoi se: *Ushtrimi i kompetencave si prokuror më i lartë, në vendimmarrjen e datës 31.05.2016, janë ushtruar prej meje në pajtim të plotë me parashikimet kushtetuese, procedurale dhe të ligjit organik në fuqi. Përdorimi i nenit 25, pika 2 e KPrP si argument për të mbështetur vendimmarrjen, është përdorur jo në mënyrë selektive dhe për të justifikuar vendimmarrjen sipas rastit, sikurse parashtron Komisioneri Publik në ankim, por është përdorur për të përcaktuar kompetencën në ushtrimin ligjor tërësisht të ndryshëm nga ai i çështjeve të vitit 2017, në të cilat Komisioneri parashtron për mosushtrim të qëllimshëm të kompetencave të mia si prokuror më i lartë. Në lidhje me konstatimin për mungesën e një vendimi të shkruar për zëvendësimin e prokurorit, sikurse kam shpjeguar më sipër në këtë rast, kompetencat e mia janë ushtruar si prokuror më i lartë në referim të nenit 25, pika 2 e K.Pr.Penale [...].*

26.7 Kolegji vëren se nga rrethanat e çështjes, si dhe referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioni, rezulton se pas disa muajsh që janë kryer hetime nga prokurori G. T. në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit, pasi ka marrë përsipër hetimin e çështjes penale, ka shpallur moskompetencën lëndore. Subjekti i rivlerësimit ka bërë një klasifikim tjetër të veprës penale, duke përjashtuar ekzistencën e bashkëpunimit në formën e grupit të strukturuar kriminal dhe nxjerrjen jashtë juridiksionit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Në fashikullin penal të administruar nga Komisioni, nuk rezulton nëse prokurori që ka ndjekur hetimet, ka hequr dorë apo ka dhënë pëlqimin për ndjekjen e hetimeve nga drejtuesi i kësaj prokurorie. Një gjë e tillë nuk del as nga vendimi i shpalljes së moskompetencës se përse ky vendim është përpiluar prej drejtuesit të Prokurorisë për Krime të Rënda (subjekti i rivlerësimit). Në këtë vendim të marrë më datë 31.05.2016, subjekti i rivlerësimit ka konkluduar, ndër të tjera, se përderisa nuk u arrit të provohej karakteri transnacional i veprave penale, arrihet në konkluzionin se të hetuarit kanë konsumuar veprën penale të parashikuar nga neni 283, paragrafi 2 i Kodit Penal, “trafikimi i lëndëve narkotike”, i kryer në bashkëpunim, duke vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore dhe kalimin e akteve të procedimit penal nr. {***} Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si prokuroria që ka kompetencën lëndore dhe tokësore.

26.8 Në përfundim të analizës së shkakut të ankimit të trajtuar më sipër, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka shpallur moskompetencën e hetimit të këtij procedimi penal pas rreth një viti nga regjistrimi i tij. Në mungesë të dokumentacionit të kalimit të çështjes për hetim nga njëri prokuror i çështjes te drejtuesi, i cili ka finalizuar këtë çështje duke shpallur moskompetencën, nuk mund të dihet me saktësi se në ç’ mënyrë është realizuar ky zëvendësim, duke mos e lejuar Kolegjin të qartësohet për bazueshmërinë e këtij akti që nuk ekziston në dosje, por nga ana tjetër edhe

subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij nuk duket bindës, për sa është shprehur dhe ka shpjeguar, duke mos provuar kështu të kundërtën e barrës së provës, si rrjedhojë subjekti ka demonstruar mangësi në drejtim të aspektit të njohurive të ligjit sipas parashikimit të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. *Sa më sipër, shkaku i ankimit i ngritur nga Komisioneri Publik, gjendet i bazuar.*

27. *Lidhur me procedimin penal nr. {***}, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku kjo e fundit ka shpallur moskompetencën tokësore, duke ia kaluar aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, regjistruar në këtë prokurori si procedimi penal nr. {***} (ku subjekti i rivlerësimit ka qenë drejtues 2013-2015), Komisioneri Publik pretendoi se baza ligjore e referuar nga subjekti në arsyetimin e vendimit për transferimin e çështjes, me atë të dispozitivit, është e ndryshme, pasi është disponuar mbi bazën e nenit 76, në vend të nenit 78 të K.Pr.Penale. Por edhe duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, sërish Komisioneri Publik pretendoi se nuk jemi para rastit kur gjen zbatim neni 78 i K.Pr.Penale. Neni 78 mund të zbatohet vetëm kur gjyqtari/prokurori merr cilësinë e të pandehurit ose të personit të dëmtuar nga vepra penale, ndërsa (në kundërshtim me këtë rast), subjekti e ka zbatuar këtë dispozitë duke iu referuar rastit të vëllait të një prokurori. Ky i fundit as nuk ka qenë i regjistruar si i dyshuar në momentin e marrjes së vendimit, dhe as më pas. Komisioneri Publik pretendoi se nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, nuk rezulton të jetë administruar vendim për zëvendësimin e prokurorit, gjë që bie ndesh dhe me vetë parashikimet ligjore të kohës mbi organizimin e prokurorisë dhe dispozitat e K.Pr.Penale.*

27.1 *Subjekti i rivlerësimit në kundërankim, në lidhje me këtë procedim penal, ka kundërshtuar se në lidhje me shkaqet për ushtrimin e kompetencës së parashikuar në nenin 25, pika 2 e K.Pr.Penale, si prokuror më i lartë, duke shpallur moskompetencën tokësore, në vendimin përkatës dhe shpjegimet e dërguara para Komisionit, rezulton se shkaku kryesor lidhet me distancën në referim të nenit 78 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikonte si kompetente për hetimin e procedimeve penale ndaj prokurorëve ose gjyqtarëve, prokurorinë më të afërt në distancë gjeografike me atë ku ushtron detyrën subjekti i rivlerësimit. Për konkluzionet e Komisionerit Publik se ky arsyetim nuk duket bindës, pa dhënë asnjë arsye apo argument që tregon të kundërtën e asaj që është shprehur me vendim të arsyetuar, subjekti pretendoi se janë të pabazuara. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se çështja e kompetencës tokësore nuk është kundërshtuar nga Prokuroria e Elbasanit. Sipas tij, referuar vendimit të moskompetencës të marrë në rastin konkret, konsideratat mbi bazueshmërinë dhe themelin e vendimmarrjes, e cila nuk rezulton të jetë cenuar si gjatë vijimit të hetimeve, ashtu edhe gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, janë tej objektit të vlerësimit të aftësive profesionale të prokurorit, sipas parashikimeve të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, neneve 40 dhe 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 69, shkronja "a" dhe 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.*

27.2 *Konkluzionet e Komisionit për këtë procedim penal: [...] subjekti i rivlerësimit, vendimin për shpalljen e moskompetencës, e ka mbështetur në ligjin referuar së drejtës funksionale, si drejtues i prokurorisë për të ndërhyrë. Ai ka ushtruar kompetencat si prokuror më i lartë, në përputhje me parashikimet e nenit 25/2 të Kodit të Procedurës Penale. Lidhur me faktin që pretendimet e*

ngritura nga denoncuesi janë gjykuar edhe nga gjykatat më të larta që kanë marrë në shqyrtim çështjen, trupi gjykues çmon se nuk ka kompetencë për të hyrë në themel të çështjes mbi atë që gjykatat më të larta kanë vendosur.

27.3 Kolegji vëren se, nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se më datë 22.02.2013, Prokuroria e Rrethit Tiranë ka regjistruar emrin e znj. T. H. (gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë) si të dyshuar për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, sipas nenit 248 të Kodit Penal. Më 18.06.2013, Prokuroria e Rrethit Tiranë ka shpallur moskompetencën për shkak të kushteve të parashikuara në nenin 78⁹ të Kodit të Procedurës Penale dhe ka transferuar çështjen pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila më 10.07.2013, ka regjistruar çështjen dhe ka vijuar hetimin. Më datë 22.11.2013, subjekti i rivlerësimit Besim Hajdarmataj, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Durrësit, ka vendosur shpalljen e moskompetencës, me arsyetimin se nga analiza e akteve të këtij procedimi penal, është konstatuar se autoriteti kompetent për vazhdimin e procedimit penal nuk ishte Prokuroria e Rrethit Durrës, si dhe transferimin e çështjes pranë Prokurorisë së Rrethit Elbasan, e cila ka regjistruar çështjen më datë 19.12.2013. Vetëm pas pesë ditësh, më 24.12.2013, prokurori që i është caktuar çështja në Prokurorinë e Elbasanit, ka pushuar procedimin penal. Në dispozitivin e vendimit të shpalljes së moskompetencës, akt i përpiluar nga subjekti i rivlerësimit, është vendosur baza ligjore e cila nuk është në përputhje me arsyetimin, pasi është shkruar neni 76, pikat 1 dhe 2 të K.Pr.Penale, në vend të nenit 78 të K.Pr.Penale.

27.4 Meqenëse prokurorja së cilës i është ngarkuar çështja në Prokurorinë e Durrësit, ishte znj. E. B., e cila kishte kryer disa veprime hetimore kur drejtuesi i prokurorisë ndërhyri, duke urdhëruar transferimin e çështjes në një zyrë tjetër, si dhe duke u nisur nga përmbajtja e denoncimit anonim ku thuhet se subjekti i rivlerësimit Besim Hajdarmataj i ka kërkuar prokurores se çështjes E. B. pushimin e hetimeve për gjyqtaren T. H., si dhe ka ushtruar presion ndaj kësaj prokuroreje, Komisioni e vlerësoi si të rëndësishme dhënien e dëshmisë nga ana e saj. Në procesverbalin e mbajtur më datë 12.06.2019, znj. B. është pyetur nga Komisioni, ndër të tjera, nëse drejtuesi i prokurorisë Besim Hajdarmataj ka ushtruar ndonjë presion për të pushuar hetimin, dhe ka konfirmuar se nuk ishte ushtruar presion ndaj saj nga drejtuesi i prokurorisë për pushimin e çështjes. Konfirmoi se, në vlerësimin e saj, fakti që ajo kishte nisur veprimet hetimore, kishte konsideruar se juridiksioni territorial i kësaj çështjeje ishte Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, pra s’kishte kontestime për juridiksionin e çështjes. Gjithashtu, dëshmitarja pohoi që kishte shqyrtuar dhe çështje të tjera të ngjashme, që ishin transferuar nga Tirana në Durrës. Pas konsultimit me dosjen, ajo deklaroi se kishte iniciuar disa veprime hetimore për këtë çështje, si:

⁹*Procedimet, në të cilat një gjyqtar ose prokuror merr cilësinë e të pandehurit ose të personit të dëmtuar nga vepra penale, që sipas normave të këtij kreu do të ishin në kompetencën e një gjykate të rrethit, ku gjyqtari ose prokurori ushtron funksionet e tij ose i ushtronte në momentin e ngjarjes, janë në kompetencën e gjykatës që ka kompetencën lëndore dhe ndodhet në qendrën e një rrethi tjetër më të afërt, me përjashtim të rasteve kur në këtë rreth gjyqtari ose prokurori ka ardhur më pas për të ushtruar funksionet e tij. Në rastin e fundit, është kompetente gjykata e një rrethi tjetër më të afërt me atë, në të cilën gjyqtari ose prokurori ushtronte funksionet e tij në momentin e kryerjes së veprës penale.*

pyetja/thirrja e disa dëshmitarëve, por që dëshmia e të cilëve nuk ishte marrë, pasi dosja u transferua në Prokurorinë e Elbasanit.

27.5 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime lidhur me këtë procedim penal, për të provuar të kundërtën, pas së cilës subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e datës 04.10.2019, ka sqaruar se: [...] *ka të bëjë me kompetencat e drejtuesit të prokurorisë, për të ndërmarrë veprime dhe vendime për çështje të prokurorëve me të ulët, siç kam vepruar në rastin konkret. Sa i përket argumentimit të shpalljes së moskompetencës të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe kalimit të akteve, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, janë marrë parasysh parashikimet e nenit 78 të K.Pr.Penale, ndërsa baza ligjore e vendosur në vendimin e datës 22.11.2013 është një lapsus, pasi mund të jetë punuar mbi akte të mëparshme, ndërkohë që analiza e shkaqeve të transferimit u referohet parashikimeve të nenit 78 të K.Pr.Penale, si një dispozitë e veçantë për punonjësit e drejtësisë (gjyqtar, prokuror). [...] Shpallja e moskompetencës është bërë në një fazë kur nuk ishte konkluduar për mënyrën e përfundimit të hetimeve dhe, për rrjedhojë, kjo zgjidhje nuk ka ndërprerë ose penguar asnjë iniciativë të vendimmarrjes së prokurorit të çështjes. Vendimi i shpalljes së moskompetencës për vijimin e mëtejshëm të hetimeve për këtë çështje, nuk e ka cenuar rezultatin e hetimeve, por as nuk ka ndërprerë ndonjë vendimmarrje të prokurorit të çështjes [...].*

27.6 Kolegji vëren se nga rrethanat e çështjes, si dhe referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë vendimin e shpalljes së moskompetencës, duke e marrë çështjen nga prokurorja e ngarkuar, E. B., dhe duke ngarkuar veten si prokuror i çështjes. Gjithashtu nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë, nuk rezulton të jetë disponuar me vendim për zëvendësimin e prokurorit, duke e bërë të paqartë ndërhyrjen e drejtuesit të prokurorisë në një fazë të avancuar të hetimeve nga prokurorja e çështjes. Arsyetimi i vendimit të shpalljes së moskompetencës nga subjekti i rivlerësimit, është i paplotë dhe i paqartë, në drejtim të nevojës që çështja të trajtohej nga ana e tij nga njëra anë, si dhe arsyet që ka paraqitur për shpalljen e moskompetencës nga ana tjetër. Në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit arsyeton se dosja hetimore do të transferohet për shkak të moskompetencës tokësore, pasi në kallëzimin që ishte bërë për gjyqtaren T. H., ishte përmendur fakti që një avokat ka pasur ndikim në vendimin e dhënë prej saj, i cili ishte vëllai i një prokurori që ishte zgjedhur në krye të Njësisë së Përbashkët Hetimore Durrës, strukturë e specializuar për hetimin e çështjeve për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në këto kushte, prezenca e tij do e bënte të paragjyqeshme çdo lloj vendimmarrjeje të prokurorit në Prokurorinë Durrës. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit rendit si shkak moskompetence edhe afërsinë me qytetin e Elbasanit, ku sipas informacionit, shprehet ai, është më e afërt se distanca Tiranë-Durrës.

27.7 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi gjatë seancave të zhvilluara në Kolegji, se: *Në lidhje me shkakun e ankimit për shpalljen e moskompetencës sipas nenit 78 të K.Pr.Penale, shkakun kryesor i kalimit të akteve Prokurorisë së Rrethit Elbasan lidhet me distancën gjeografike. [...] ushtrimi i një kompetence ligjore në referim të nenit 25, pika 2 e K.Pr.Penale, është bërë vetëm disa muaj pas regjistrimit të procedimit dhe në atë moment, hetimi nuk ka qenë në fazën përfundimtare të tij.*

Përveç arsyes që lidhet me distancën në vendimin e shpalljes së moskompetencës, kam referuar si shkak, megjithëse jokryesor, edhe pretendimet e kallëzuesit lidhur me avokatin A. Sh., për të cilin pretendohet se kishte ndikuar te gjyqtarja që procedohej. Duke vlerësuar se Njësia e Përbashkët hetimore në Prokurorinë e Rrethit Durrës, e cila kishte në kompetencë hetimin e këtyre veprave penale drejtohej nga vëllai i këtij avokati, me qëllim shmangien e çdo pretendimi të mundshëm mbi zhvillimin e këtij hetimi dhe garantimin e zhvillimit të hetimit në mënyrë të pavarur, kam vlerësuar këtë situatë si shkak për të mbështetur këtë konkluzion për kompetencën sipas parashikimeve të nenit 78 të K.Pr.Penale.

27.8 Në vendimin e shpalljes së moskompetencës, vërehet gjithashtu se baza ligjore e referuar nga subjekti në arsyetimin e vendimit për transferimin e çështjes, me atë të dispozitivit, është e ndryshme, pasi është disponuar mbi bazën e nenit 76, në vend të nenit 78 të K.Pr.Penale. Por, për arsyet të cilat ka renditur subjekti i rivlerësimit në vendimin e shpalljes së moskompetencës, sërish nuk jemi para rastit kur gjen zbatim neni 78 i K.Pr.Penale. Edhe pse subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij (paragrafi 27.5 më sipër), pas kalimit të barrës së provës, është shprehur se jemi para një gabimi material në lidhje me bazën ligjore, pasi vendimi mund të jetë punuar mbi një akt tjetër ekzistues, kjo nuk e shëron gabimin ose pakujdesinë në dispozitivin e vendimit. Në dispozitiv është vendosur neni 76, pikat 1 dhe 2 të K.Pr.Penale, ndërsa neni 78 është paragrafi i vetëm, ndaj nuk krijon bindjen që mund të jetë një gabim material, siç pretendoi subjekti i rivlerësimit.

27.9 Kolegji vëren se nga analiza e shkakut të ankimit për këtë procedim penal, rezultoi se edhe në këtë rast, subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mangësi në drejtim të aspektit të njohurive ligjore sipas nenit 73, pika 2 e ligjit nr .96/2016. Veprimtaria e subjektit të rivlerësimit në kushtet e mosrespektimit të ligjit, duket se ka prodhuar një vendimmarrje që ka shmangur vënien para përgjegjësisë sipas ligjit të personave nën hetim, duke qenë se procedimi është pushuar vetëm pas disa ditësh pasi çështja ka mbërritur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Mungesa e dokumentimit të kalimit të dosjes nga prokurorja B. te subjekti i rivlerësimit që për më tepër finalizohet me vendim moskompetence, e bën të paqartë dhe arbitrare ndërhyrjen e drejtuesit të prokurorisë në një fazë të avancuar të hetimeve nga prokurorja e çështjes. Si rrjedhojë, për të gjitha rrethanat e cituara më lart, të konstatuara në fashikullin penal, nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, *shkaku i ankimit i ngritur nga Komisioneri Publik gjendet i bazuar në prova e në ligj.*

27.10 Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e aftësisë profesionale, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit gjendet në situata të përsëritura, një ndër të cilat është transferuar për vlerësim në organet kompetente, por që duke vlerësuar edhe denoncimet për të cilat janë shqyrtuar procedimet penale të mësipërme, vërehet një përsëritje e shkeljeve të subjektit të rivlerësimit, të cilat rëndojnë pozitën e tij në drejtim të vlerësimit profesional, si dhe bie ndesh me nenin 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *[...] Komisioni ka të drejtë të transferojë çështjen pranë organit kompetent për inspektim në rast se evidenton shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore [...]. Ky kusht është i lidhur me konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, që do të thotë se Komisioni, pasi ka bërë një hetim të thelluar, ka vendosur që subjekti të vijojë të qëndrojë në*

sistemin e drejtësisë, por duke evidentuar shkaqe që mund të përbëjnë shkelje, të cilat praktikisht duhet të jenë të lehta, dhe brenda afateve të parashikuara në nenin 117 të ligjit nr. 96/2016, për sa kohë subjekti i rivlerësimit është konfirmuar, dhe nuk duhet të cenon besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

27.11 Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, datë 18 janar 2017, në paragrafin 54 të tij citohet: *Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias).*

27.12 Në përfundim të analizës që lidhet me shkaqet e ankimit për kriterin e aftësive profesionale, Kolegji konkludon se kur gabimet e subjekteve të rivlerësimit evidentohen që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe në praktika të ndryshme, përbëjnë përjashtim nga rastet e konfirmimit në detyrë dhe duhet të vlerësohen negativisht. Konkretisht, gjendja e përsëritur e gabimeve në gjykim, dëshmon për praninë e mangësive profesionale¹⁰ të evidentuara në pesë procedimet penale të shqyrtuara në kuadër të denoncimeve të dërguara në Komision, mbi të cilat, siç parashikon neni 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit mund të vlerësohet “i papërshtatshëm” për kriterin e aftësive profesionale, pasi në përputhje me interpretimin pajtues të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, konstatohen raste të gjyqimeve me gabime thelbësore, serioze dhe të përsëritura. Kolegji i vlerësoi në tërësi të gjitha konstatimet e mësipërme të arritura për procesin e rivlerësimit, por jo vetëm, dhe arriti në përfundimin se ato janë të tilla që e çojnë Kolegjin në konkluzionin se subjekti, me veprimtarinë e tij, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

28. Lidhur me çështje të tjera, si përdorimi i makinës dhe kontaktet, Komisioneri Publik pretendoi në ankim se Komisioni ka ardhur në dijeni të kontakteve të subjektit të rivlerësimit me persona me precedentë penalë, si dhe të faktit se ka udhëtuar me ta dhe me makinat e tyre, fakt i cili duhet të shihet në vështrim të vlerësimit tërësor të çështjes. Komisioneri Publik pretendoi se rezultoi e provuar që subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar edhe me shtetasit V. K. dhe S. K., të dy të proceduar penalisht, duke vlerësuar se të gjitha rrethanat e mësipërme mbartin në vete dyshimin e arsyeshëm për kontakte të subjektit të rivlerësimit me persona me precedentë penalë, fakt i cili duhet çmuar në vlerësimin tërësor të çështjes, si dhe në kuptim të nenit 4, pika 2 dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr.

¹⁰ “I papërshtatshëm”, kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit, ose nuk ka kaluar me sukses testimin pranë Shkollës së Magjistraturës.

84/2016. Gjithashtu Komisioneri Publik shprehet në ankim në lidhje me një policë sigurimi të lëshuar për një automjet tip "Audi A4", në pronësi të shtetasës M. W., me përdorues z. Besim Hajdarmataj.

28.1 *Subjekti i rivlerësimit në kundërankim* ka kundërshtuar se pretendimi i Komisionerit Publik për kontakte me persona me precedentë penalë, është tërësisht i pabazuar në faktet dhe rrethanat që kanë rezultuar nga hetimi administrativ dhe nuk përben në asnjë rast rrethanë që cenon figurën e tij si subjekt rivlerësimi, në kuptim të nenit Dh, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 3, pika 15, neneve 34 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016. Raporti i DISK-së, si organ ndihmës në lidhje me kontrollin e figurës të subjekteve të rivlerësimit, ka konkluduar në përshtatshmërinë për vijimin e detyrës, pasi nuk ka administruar asnjë të dhënë që mund të ngrejë dyshime mbi pastërtinë e figurës. Subjekti i rivlerësimit parashtrori se Komisioni, duke iu referuar pretendimeve të denoncuesve, ka kryer një hetim të plotë, të thelluar dhe të gjithanshëm, duke mbledhur një tërësi provash dhe të dhënash nga analiza e të cilave nuk rezultoi asnjë element apo e dhënë që të cenojë pastërtinë e figurës.

28.2 Kolegji vëren se gjatë hetimit administrativ në Komision, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me shkresën nr. {***}, datë 22.11.2018, ka informuar Komisionin se shoqëria “{***}” ShA ka lëshuar në emër të subjektit të rivlerësimit policën e sigurimit, me numër serie {***}, për një periudhë mbulimi nga data 18.12.2010 deri në datën 17.12.2011. Kjo policë sigurimi ishte lëshuar për një automjet tip "Audi A4", në pronësi të znj. M. W., me përdorues, z. Besim Hajdarmataj. I pyetur nga Komisioni në pyetësin nr. 7, subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e datës 12.12.2018, ka sqaruar se: *Jam shumë i surprizuar në lidhje me policën e sigurimit për vitin 2010-2011 ku ndodhet emri im dhe i vëllait tim G.it. I kam kërkuar shpjegime vëllait tim lidhur me këtë fakt dhe më ka sqaruar se: "E kam paguar unë këtë policë, por nuk ju kam bërë ju me dije pasi nuk e kam vlerësuar këtë fakt". Nëse do isha dijeni të faktit të pagimit të kësaj police sigurimi, nuk do të kisha asnjë arsye për ta mohuar [...].*

28.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim “DPSHTRR”), me shkresën nr. {***} prot., datë 26.12.2018, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ka informuar se nga verifikimet e bëra në sistemin elektronik, ka rezultuar se automjeti tip "Audi", me ngjyrë të zezë, me nr. karrocierie {***}, nuk figuron i regjistruar në DPSHTRR. Po ashtu, ka informuar se shtetasja M. W. nuk ka automjete të regjistruara pranë DPSHTRR.

28.4 Kolegji, në lidhje me faktet dhe rrethanat që rezultuan rreth policës së sigurimit për automjetin tip "Audi A4", në pronësi të shtetasës M. W., me përdorues subjektin e rivlerësimit, duke parë që edhe Komisioneri Publik nuk ka mbajtur qëndrim konkret ligjor për këto fakte dhe rrethana, nuk i çmoi të rëndësishme dhe relevante për çështjen, pasi nuk lidheshin me ndonjë pasojë ligjore që ka të bëjë me procesin e rivlerësimit.

28.5 Kolegji konstaton se, nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me shkresën nr. {***} prot., datë

30.04.2019, ka informuar se për shtetasin V. K., është regjistruar procedimi penal me nr. {***} i vitit {***}, për veprën penale të “Trafikimit të mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal. Në momentin kur janë administruar aktet e fashikullit, ky procedim penal ishte i pezulluar, në pritje të letërporosisë. Një shënim i tillë është vënë edhe në sistemin TIMS të këtij shtetasi, në rubrikën “shënime”, ku për këtë vepër penale shpallet në kërkim. Ndërsa Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. {***} prot., datë 07.05.2019, ka informuar se për shtetasin S. K., më datë 17.10.2018 është regjistruar procedimi penal nr. {***}, për veprën penale “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298, paragrafi 3 i Kodit Penal, çështje e cila është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Gjithashtu për këtë shtetas, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë, me shkresën nr. {***} prot., datë 17.06.2019, ka informuar se është regjistruar procedimi penal nr. {***}, për të cilin është vendosur mosfillimi i tij më datë 30.01.2019.

28.6 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se nga të dhënat e informacionit të aksesuar në sistemin TIMS, subjekti i rivlerësimit rezulton me hyrje-dalje nga Shqipëria me mjetin me targë {***}, mjet i cili është në pronësi të shtetasit V. K., ku subjekti i rivlerësimit ka qenë herë shofer e herë pasagjer. Po nga të dhënat e këtij sistemi, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar disa herë jashtë Shqipërisë në vitet 2015 dhe 2016 me automjetin me targën e sipërcituar në pronësi të V. K., ku disa herë ka qenë në pozicionin e shoferit dhe disa herë në pozicionin e pasagjerit, ku drejtues mjeti në këtë rast ka qenë shtetasi S. K..

28.7 Nga rrethanat e mësipërme që rezultuan nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje, si dhe nga qëndrimet e subjektit të rivlerësimit gjatë pyetjes për gjetjet e rezultuara, Kolegji arsyeton se është në përgjegjësinë e subjekteve të rivlerësimit të tregojnë kujdesin e shtuar për të evituar marrëdhënie të tilla nëpërmjet përdorimit të automjeteve në pronësi të personave me precedentë penalë. Këto rrethana krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte me shtetasit S. K. dhe V. K., për sa kohë ka përdorur disa herë automjetin e këtij të fundit për hyrje-dalje jashtë territorit shqiptar gjatë periudhës që ky i fundit e ka pasur në pronësi të tij këtë mjet. Edhe pse veprat penale për të cilat janë akuzuar këta shtetas nuk përfshihen në rrethin e veprave penale të përcaktuara nga neni 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, nuk konsiderohen persona të përfshirë në krimin e organizuar, sjelljet e subjektit të rivlerësimit, i cili udhëton me persona me precedentë penalë, si dhe përdor automjete të këtyre personave, mbahen parasysht nga Kolegji për kategorizimin si shkelje që cenon besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

- 29.** Kolegji, në sintezë të sa më sipër, në përgjigje të diskutimeve përfundimtare të Komisionerit Publik dhe të subjektit të rivlerësimit, pasi vlerësoi të gjitha shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të pasurisë dhe aftësisë profesionale, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore të përbërë nga aktet e përcjella në Kolegji nëpërmjet fashikullit të Komisionit, dhe aktet e depozituara në cilësinë e provës nga subjekti i rivlerësimit, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, arriti në konkluzionet e mëposhtme.

Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë

I. Sipas analizës financiare të kryer nga Kolegji për vitet 2010-2013, në funksion të shqyrtimit të shkakut të ankimit lidhur me situatën financiare të subjektit të rivlerësimit për këtë periudhë, rezultoi se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve në këto vite, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

II. Kolegji konstatoi se shuma monetare e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, si një pasuri likuiditet në gjendje *cash*, tejkalon limitin prej 1.500.000 lekësh të lejuar për t’u mbajtur si e tillë, sipas përcaktimeve të shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, duke prodhuar si pasojë mosplotësimin me saktësi e në përputhje me ligjin të deklaratës së pasurisë *vetting*, situatë e cila nuk plotëson kërkesat e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

III. Rrethanat faktike të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me kontributin financiar të vëllait të tij A. H., në drejtim të financimit të blerjes së pasurisë që shërben si banesë e subjektit të rivlerësimit dhe pasurisë likuiditet në monedhë të huaj të deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë *vetting*, mbeten jobindëse se kanë ndodhur, pas një analize logjike e të arsyeshme të dedikuar rastit konkret, dhe u konsideruan me këtë status prej Kolegjit në vlerësimin e përgjithshëm të çështjes.

Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale

IV. Kolegji konstatoi se në procedimin penal nr. {***} të vitit {***}, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, por edhe të drejtuesit të zyrës, ka demonstruar minimalisht mangësi të theksuara të njohurive të ligjit për shkak të rolit të tij pasiv në drejtimin e veprimtarisë hetimore në funksion të zbardhjes së ngjarjes e vënies para përgjegjësive ligjore të autorëve përkatës, si edhe ka pamundësuar ushtrimin e të drejtave të kallëzuesve për të ankimuar vendimin e marrë prej tij. Problematikat e hasura në këtë procedim, konsiderohen prej Kolegjit se janë serioze dhe të papranueshme, duke pasur në vëmendje natyrën e çështjes dhe impaktin e saj në drejtim të ruajtjes së autoritetit të institucioneve shtetërore, si një element i rëndësishëm për funksionimin e shtetit të së drejtës, si edhe eksperiencën dhe profilin drejtues të subjektit të rivlerësimit, rrethana për shkak të të cilave subjekti i rivlerësimit duhej të kishte ushtruar kujdes dhe vëmendje të posaçme. Kolegji vlerëson se rrethanat e mësipërme e vendosin subjektin në kushtet e defekteve në drejtim të aspektit të njohurive ligjore, në kuptim të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

V. Kolegji konstatoi se në procedimin penal nr. {***} të vitit {***}, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e tij si drejtues, para ndryshimeve kushtetuese mbi strukturën organizative të institucionit të prokurorisë, ka marrë vendimin për shpallje të moskompetencës së Prokurorisë pranë Gjykatës për Krime të Rënda dhe dërgimin për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës të çështjes, duke shmangur nga vendimmarrja prokurorin e çështjes që ishte i ngarkuar me hetimin dhe kishte regjistruar procedimin. Ndërhyrja e subjektit të rivlerësimit në këtë procedim penal, rezulton të jetë e paformalizuar në drejtim të cilësisë së subjektit në të. Nuk rezulton që ai të jetë përfshirë në rolin e prokurorit më të lartë në ushtrim të kompetencave kontrolluese nëpërmjet ndryshimit apo shfuqizimit të vendimit të prokurorit të çështjes, në kuptim të nenit 24, pika 5 e Kodit të Procedurës Penale, dhe as të ketë marrë atributet e prokurorit të çështjes si prokuror më i lartë, në kuptim të

nenit 25, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, për sa kohë që nuk rezulton asnjë akt zëvendësimi apo dorëheqje e prokurorit të çështjes sipas neneve 26 e 27 të Kodit të Procedurës Penale, i cili do ta nxirrte atë jashtë funksioneve të ushtrimit të ndjekjes penale në çështjen në fjalë, për të cilën ai kishte bërë hetimet. Përpos kësaj mangësie në zbatimin e ligjit, duket se, sipas perceptimit të një vëzhguesi të zakonshëm publik, vendimi i marrë prej subjektit të rivlerësimit në kushtet e mësipërme të mosrespektimit të ligjit, ka kufizuar hetimet e mëtejshme të aktivitetit kriminal në drejtim të veprave penale më të rënda, hetime të cilat nuk mund të kryheshin më tej nga prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe as të cilësoheshin si akuza të reja nga gjykata që gjykoj çështjen në kuptim të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale. Edhe në lidhje me këtë rast, Kolegji vlerëson se subjekti ka demonstruar mangësi në drejtim të aspektit të njohurive të ligjit, sipas parashikimit të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

VI. Kolegji konstatoi se në procedimin penal nr. {***} të vitit {***}, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në cilësinë e tij si drejtues i zyrës, para ndryshimeve kushtetuese mbi strukturën organizative të institucionit të prokurorisë, subjekti i rivlerësimit ka vendosur shpalljen e moskompetencës, si dhe transferimin e çështjes në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke shmangur nga vlerësimi i këtij hapi procedural prokuroren e çështjes, e cila kishte kryer veprimtarinë hetimore. Kolegji vlerëson edhe në këtë procedim se janë të pranishme të gjitha argumentet mbi mosrespektimin e ligjit lidhur me marrjen e kompetencave të një prokurori më të ulët, të përmendura në rastin e mësipërm. Për më tepër, konstatohet se shkaku për të cilin është vendosur shpallja e moskompetencës nuk ka qenë një fakt i rezultuar nga hetimet, por i ditur që në nisje të tyre. Për pasojë, edhe në versionin e drejtësisë së vendimmarrjes së subjektit, reagimi i tij ka qenë i vonuar. Edhe në këtë rast, në vlerësimin e një vëzhguesi të zakonshëm publik, veprimtaria e subjektit në kushtet e mosrespektimit të ligjit, duket se ka prodhuar një vendimmarrje që ka shmangur vënien para përgjegjësisë sipas ligjit të personave nën hetim, duke qenë se procedimi është pushuar vetëm pas disa ditësh pasi çështja ka mbërritur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Edhe në këtë rast, Kolegji vlerëson se subjekti ka demonstruar mangësi në drejtim të aspektit të njohurive ligjore sipas nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

VII. Lidhur me procedimet penale nr. {***} të vitit {***} dhe nr. {***} të vitit {***} të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në të cilat subjekti i rivlerësimit ka qenë në rolin e drejtuesit të zyrës, pas ndryshimeve kushtetuese mbi strukturën organizative të institucionit të prokurorisë, Kolegji konstaton se prej tij nuk është treguar kujdesi dhe vlerësimi i duhur për ndjekjen e hetimeve të kryera për këto çështje, monitorimin e tyre dhe nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse që do të dëshmonin ushtrimin e funksioneve drejtuese me përgjegjshmëri. Fakti që nuk ka gjurmë të veprimtarisë së tij si drejtues, apo ato janë shumë të vonuara, në zbatim të neneve 43, shkronjat “b” dhe “d” dhe nenit 48 të ligjit nr. 97/2016, deri në vendimet për shpalljen e moskompetencës së Prokurorisë pranë Gjykatës për Krime të Rënda, tregon për mangësi në ushtrimin e funksioneve drejtuese në çështje të cilat për shkak të sasive shumë të mëdha të lëndës narkotike të sekuestruar, ashtu edhe për shkak të hetimeve me karakter transnacional, duhej të kishin një vëmendje e kujdes të shtuar të subjektit, veçanërisht në situatën shumë sensitive në drejtim të veprimtarisë kriminale të prodhimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike. Pasiviteti i subjektit të rivlerësimit në këto çështje, duke konsideruar edhe rrjedhën e këtyre hetimeve në prokuroritë ku ato u përcollën, do të perceptohej nga një vëzhgues i zakonshëm i publikut si ndikim në drejtim të dobësimit të forcës goditëse të institucioneve ndaj kësaj veprimtarie.

VIII. Kolegji vlerësoi gjithashtu se marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me shtetasit S. K. dhe V. K., të cilët rezultojnë individë me precedentë penalë, janë elemente që tregojnë për një sjellje jashtëgjyqësore jo të denjë për një funksionar të një niveli të tillë, të cilat do të perceptoheshin negativisht në syrin e një vëzhguesi të zakonshëm publik dhe pritshmëritë e tij për figurën publike të një magjistrati në funksionet e subjektit të rivlerësimit.

30. Në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji vlerësoi në tërësi, të gjitha konstatimet e mësipërme të arritura për procesin e subjektit të rivlerësimit dhe arriti në përfundimin se ato janë të tilla që e çojnë këtë trupë gjykuese në konkluzionin se subjekti me veprimtarinë e tij, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në një mënyrë të pariparueshme nëpërmjet programeve të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës. Për këto arsye, vazhdimi i ushtrimit prej tij të funksioneve të prokurorit do të ishte i papërshtatshëm dhe në kundërshtim me qëllimin dhe parashikimet e nenit 179, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për pasojë, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duhet vendosur shkarkimi i tij nga detyra.
31. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Kolegji çmon se vendimi i Komisionit nr. 200, datë 16.10.2019, duhet ndryshuar pasi nuk gjendet i drejtë e i bazuar në fakte, prova dhe ligj.

PËR KËTO ARSYE,

trupit gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 200, datë 16.10.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Besim Hajdarmataj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 04.08.2021, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATOR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi